

PROZA TREGIMTARE E HAKI STËRMILLIT

Dr. Kajtas Rrecaj

Instituti Albanologjik
i Prishtinës

KUD 891.983—32.09
Stërmilli, H.
Punim studimor

Marrë për botim më 21 shtator 1987

Stërmilli la në dorëshkrim dy përmbledhje me tregime — përmbledhjen „Zemra të shitueme” dhe „Hijet e kuqe” me më se pesëdhjetë tregime, prej të cilave i botoi më se dyzet. Tregimet e Stërmillit u botuan në dy periudha kohore. Grupin e parë të tregimeve Stërmilli e botoi në fillim të viteve 1920, kurse të dytin në fillim të viteve 1940. Tregimet e Stërmillit trajtojnë temën e dashurisë, temën e atdheut dhe temën e moralit, sipas të cilave kemi bërë tipologjinë dhe analizën e tyre.

Publiku lexues i sotëm nuk di shumë për Haki Stërmillin si lëruet të tregimit. Kjo është e kuptueshme meqenëse deri më tashti askush nuk i tuboi tregimet e Stërmillit që t’i botojë në një vëllim, i cili nuk do të ishte i vogël, përkundrazi, do të ishte shumë voluminoz. Në anën tjetër, numri më i madh i tregimeve të Stërmillit u botua në periodikun e kohës para më se gjashtëdhjetë vjetësh, që nuk është lehtë të gjendet — në periodikun e viteve 1922, 1923 e 1924, për të vazhduar mandej botimi i tregimeve të tjera afër njëzet vjet më vonë — në vitet 1942 e 1943. Po të shfletohen gazetatat e reristat „Tomori”, „Tomori i rogël”, „Shtypi”, „Elbasani”, „Afrimi”, „Koha”, „Votra shqiptare”, „Dajti” e ndonjë tjetër e viteve të lartpërmendura, do të shohim se në ato vite u botuan më se dyzet tregime të Stërmillit. Nga shënimet e kohëpaskohshme të Stërmillit, në fillim apo në mbarim të disa tregimeve të botuara, shihet se ka dy përmbledhje tregimesh në dorëshkrim — ka përmbledhjen „Zemra të shitueme” me më se tridhjetë tregime dhe përmbledhjen „Hijet e kuqe” me „25 novela që flasin për jetën e shqiptarëve të robnuem” — siç pohon autori.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (1912) dhe deri në fillim të viteve njëzet të shekullit tonë, letërsia shqipe vazhdoi rrugën e letërsisë së Rilindjes Kombëtare-vazhdoi të shkruhet në formacionin stilistik të romantizmit. Me shpalljen e Pavarësisë së

Shqipërisë nuk u sigurua edhe integriteti i saj, prandaj çështja e formimit apo e sforcimit të vetëdijes kombëtare ishte ende temë preokupimi e shkrimtarëve shqiptarë, meqë e shihnin rrezikun e copëtimit e të pavarësisë së Shqipërisë, prandaj e panë të arsyeshme të vazhdojnë rrugën e letërsisë së Rilindjes për të mobilizuar masën, për të mbajtur të zgjuar vigjilencën për mbrojtjen e vendit nga synimet okupuese të qeverive të huaja borgjeze. Në këtë kohë, kur mund të pritej që realizimi, i filluar vite më parë në letërsinë shqipe, të bënte shtegun kryesor, filluan të ndihen edhe tone të tjera, që në letërsinë evropiane i kanë paraprirë romantizmit, madje edhe pseudoklasicismit, si, për shembull, në letërsinë angleze. Këto tone janë tonet e letërsisë sentimentaliste, që në lartësinë shqipe u manifestuan në prozë. Edhe në këtë pikëpamje, letërsia shqipe dallon nga ajo evropiane. Derisa, për shembull, në letërsinë angleze sentimentalizmi është më i theksuar në poezi, në letërsinë shqipe realizohet në epikën prozaikë dhe, më pak, në dramë. Megjithatë, shenjat e sentimentalizmit në letërsinë shqipe duken edhe më parë — në veprat e Muhamet Çamit, në „Erveheja” e në „Jusufi e Zelihaja” dhe, më pak, në veprat e De Radës, sidomos në veprën „Këngët e Milosaos”. Sentimentalizmi shqiptar nuk ka shumë përfaqësues dhe nuk arriti të formojë bazë teorike e as shkollë letrare. Përfaqësuesit kryesorë të sentimentalizmit në letërsinë shqipe janë, kush më pak e kush më shumë, autorët e parë të prozës shqipe, si p.sh. Ndoc Nikaj, Mihal Grameno, Foqion Postoli, Filip Papajani-Lipi, Milto Sotir Gurra, e, sidomos, Haki Stërmilli.

Kushtet politike, ekonomike e shoqërore në një kohë të caktuar kushtëzuan paraqitjen e sentimentalizmit në letërsinë shqipe më vonë se në letërsinë e popujve të tjerë. Problemet e shumta në shoqërinë e shtetit të ri shqiptar pritnin transformimin artistik. Stërmilli e ndiente obligim të merrej me të dhe të ndikonte në përmirësimin e raporteve shoqërore duke u mbështetur më shumë në ndjenjat e përjetimit të realitetit shoqëror. Kështu, mendimet liridashëse e demokratike dhe flijimi për to, nderi familjar dhe i bashkëshortësisë, dashuria e besnikëria në mes të të dashuruarve, miqësia, virtyti, urtësia, matura, dënimi i veseve, dashuria ndaj njeriut e natyrës, paraqitja e njerëzve naivë e të ndershëm, jeta intime, emocionet e përjetimet, shprehja patetike, dominimi i ndjenjës mbi arsyen, ofshamet, sëmundjet e vdekjet e shpeshta nga pikëllimi janë elemente që e karakterizojnë prozën tregimtare të Stërmillit, dramën e para të tij dhe romanin „Sikur t’isha djalë”. Prandaj, zgjedhja e temave, zgjedhja e problemeve, zgjedhja e personazheve e fati i tyre dhe forma e trajtimit letrar në tregimet e Stërmillit janë tipike për letërsinë sentimentaliste.

Stërmilli ka besim të madh në rolin e letërsisë në shoqëri dhe këtë rol e sheh edhe më të madh nëse me krijimin letrar preken, në rend të parë, emocionet, prandaj përpiqet t’u bie atyre telave,

që, sipas mendimit të tij, tingëllojnë më shumë. Ai preku problemet shoqërore duke u rënë më shumë dhembjeve, emocioneve me dëshirë që ta bëjë lexuesin t'i vijë keq për fatin e personazheve të veprave të tij dhe, njëherësh, ta bëjë lexuesin që të zotohet për t'i luftuar shkaqet që i bëjnë të vuajnë këto personazhe. Por, edhe pse Stërmilli i qëndroi besnik sentimentalizmit deri në fund të krijimtarisë së tij, elementet romantike dhe realiste janë mjaft të dukshme në prozën tregimtare të tij dhe sidomos në prozën romaneske e në ditarë.

Tipologjia e prozës tregimtare të Stërmillit

Prozën tregimtare Stërmilli e kultivoi në dy faza me distanca kohore jo të vogla. Tregimet e para i botoi në fillim të viteve njëzet, kurse të dytat në fillim të viteve dyzet. Me gjithë distancën kohore prej njëzet vjetësh, në tregimet e Stërmillit nuk vërehen ndryshime as në tematikë e as në cilësinë e trajtimit të tyre — në strukturë. Madje, duke u mbështetur në makrostrukturën dhe në mikrostrukturën e tyre, krijohet përshtypja se të gjitha tregimet Stërmilli i ka shkruar në një kohë — në fillim të viteve njëzet, por, për shkaqe të ndryshme, disa u botuan më vonë. Këtë konstatim e sforcon edhe shënimi i shpeshtë i Stërmillit — „Nga volumi „Zemra të shitueme” ose Nga volumi „Hijet e kuqe”, që e hasim herë në fillim e herë në fund të disa tregimeve të botuara në fillim të viteve njëzet dhe të atyre të botuara njëzet vjet më vonë. Sa u përket temave të tregimeve të Stërmillit do theksuar që në fillim se shumica e temave të tregimeve të tij janë shfrytëzuar edhe më parë, janë shfrytëzuar nga shkrimtarët e Rilindjes si dhe nga bashkëkohanikët e Stërmillit para dhe pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Çështja e atdheut, dashuria, ruajtja e pastërtisë morale dhe, në rend të parë, pozita e femrës shqiptare janë preokupime të krijimtarisë letrare të Stërmillit. Pamundësia për t'u martuar dy të rinj të dashuruar për shkaqe të pozitive klasore dhe politike të familjeve të tyre është temë dominuese e tregimeve të Stërmillit e shfrytëzuar shumë nga Mihal Grameno e Foqion Postoli.

Stërmilli u mor shpesh me disa segmente të caktuara të jetës shoqërore sikur të mos ishte i kënaqur me atë që e kishte shkruar më parë, sikur nuk e gjente shkakun e vërtetë të të gjitha përjetimeve të hidhura e tragjike të vajzës shqiptare, në rend të parë, dhe të rinisë shqiptare në përgjithësi. Ai iu kthye shpesh të njëjtave sfera jetësore i shtyrë nga kërkesa e brendshme, nga nevoja për të folur me fjalën artistike për probleme shoqërore e politike, për problemet e vajzës dhe në përgjithësi të gruas shqiptare, për t'i folur lexuesit, për t'i folur shoqërisë që ta shohë drejt hallin, pozitën e rëndë të rinisë shqiptare, sidomos të vajzës me kërkesë

që secili, brenda mundësive e kompetencave të veta, të japë kontributin për përmirësimin e jetës së rinisë shqiptare e të krejt popullit, për emancipimin, për arsimimin e për trajtimin e drejtë shoqëror të femrës shqiptare. Janë këto elemente të mjaftueshme që prozën tregimtare të Stërmillit e bëjnë thellësisht demokratike, kurse autorin e saj e shquajnë si humanist të vërtetë. Stërmilli u kujdes të kapë aso temash njerëzore që ishin plagë të rënda shoqërore, që e mundonin popullin shqiptar në përgjithësi dhe rininë e tij në veçanti. Ai u kujdes që të gjitha tregimet t'i ndërtojë mbi bazën e raporteve shoqërore. Prandaj, tregimet e Stërmillit, pa marrë parasysh tipin e tyre, kanë taban të fortë social.

Në botën letrare Stërmilli debutoi me tregime. Nisi në atë kohë kur proza tregimtare shqiptare, me Ndoc Nikajn, me Gramenon, me F. Postolin, me M. S. Gurrën, me Lipin e me ndonjë tjetër kishte hedhur hapat e parë jo aq të sigurtë dhe ende s'kishte arritur të formojë poetikën e vet. Prandaj, sikundër është e kuptueshme, tregimet e Stërmillit duhet shikuar me syrin e kohës, me shijen e me kërkesat e saj dhe sidomos me poetikën e letërsisë sentimentaliste të mbujtur me naivitet simpatik, ku Stërmilli hoqi hullinë kryesore të sentimentalizmit shqiptar.

Veç përcaktimit që të zgjedhë tema interesante, tema shqetësuese-tema emocionale, Stërmilli kujdesej shumë që për tregimet e veta të gjejë edhe tituj adekuatë, tituj që, sipas bindjes së tij, duhet të prekin drejtpërdrejt zemrën e lexuesit. Prandaj, Stërmilli i emërtoi përmbledhjet e tregimeve në dorëshkrim me emra emocionaues („Zemra të shitueme”, „Hije të kuqe”), kurse tregimet e veçanta i emërtoi: „Zemra të dënueme”, „Zi e ma zi”, „Për hir të nderit”, „Kangë e vaj”, „Të fejuemit”, „Dy anmiqt”, „Asaj që më tradhtoi”, „Atij që më trathtoi”, „Cila je?”, „Dy zemrat e pabashkueme”, „Mbi vorr të dëshmorit”, „Flok' arta”, „Përsëri asaj që më trathtoi”, „Fati napran”, „Zemra të flijueme”, „Fatushja”, „Tinzitë e gozhdës”, „Lulja Kruetane”, „Kobi”, „Nji të puthun”, „Andërr e trishtueshme”, „Lotët e mi”, „Trimënia e grues shqiptare”, „Zemra që lëngojnë” e të tjera, të cilat, në mënyrë sugjeshive e orientojnë lexuesin për të pritur një ngjarje të caktuar tronditëse, por të përshkuar nga një ndjenjë njerëzore. Stërmilli e sheh vlerën e veprës letrare në fabulën interesante të saj dhe ky parim e karakterizon strukturën poetike të tregimeve të tij dhe të të gjitha veprave letrare të tij. Përveç kësaj, Stërmilli i kushton rëndësi të madhe edhe lëmit jetësor nga i cili i merr temat e tregimeve. Ai hulumton në segmentet më të ndieshme të jetës shoqërore dhe atje merr temën e dashurisë, temën e atdheut, temën e moralit. Këto tema, mandej, formojnë tipin e tregimeve të Stërmillit, determinojnë tipologjinë e tyre. Kështu, tema e atdheut, tema e dashurisë dhe tema e moralit janë lënda e më se dyzet tregimeve (të botuara) të Stërmillit. Rëndom, Stërmilli i trajton këto tema veç e veç në tregime të caktuara, por shpesh i bashkon

nga dy tema, nga dy motive dhe i trajton në të njëjtin tregim. Në këtë mënyrë, tregimet e Stërmillit formojnë katër lloje-tipa të tregimeve: tipin e tregimeve me dy motive, tipin e tregimeve të moralit, tipin e tregimeve të dashurisë dhe tipin e tregimeve të atdheut. Sikundër është thënë edhe më parë, temat e prozës tregimtare të Stërmillit kanë platformë të gjerë sociale dhe në bazë të kësaj do të duhej të veçohet edhe tipi i tregimit social. Po të bëhet një gjë e tillë, do të dilnin probleme të tjera dhe si problem kryesor do të ishte kriteri për të caktuar tipin e pestë të tregimeve të Stërmillit — tipin e tregimit social. Duke u mbështetur në faktin se Stërmilli edhe çështjen patriotike e vë mbi baza sociale, se edhe dashurinë e sheh në dritën e raporteve të drejta shoqërore, se edhe problemet që kanë të bëjnë me moralin i trajton duke pasur parasysh thelbin social të tyre, problemi social nuk formon tip të veçantë e, të thuash, të pastër social të tregimit, por ai gërshetohet në të gjitha tregimet e të katër tipave të lartpërmendur, radhitjen e të cilëve po e bëjmë duke u bazuar në numrin e tregimeve të tipit të caktuar.

1. Tipi i tregimit me dy motive

Kur studiuesi dëshiron të hetojë tipologjinë e tregimeve të Stërmillit, ai do të gjendet para një fenomeni që nuk është i rëndomtë në prozën tregimtare shqiptare, por që është karakteristike strukturore e tregimeve të këtij shkrimtari. Siç dihet, në tregim shtjellohet një ngjarje me rëndësi të posaçme në kushte të caktuara shoqërore dhe me pak personazhe. Në këtë pikëpamje, Stërmilli bën përjashtim dhe e thyen strukturën e rëndomtë të tregimit. Kjo dukuri lidhet me konceptin që Stërmilli ka për letërsinë dhe me obligimin që ai ndien ndaj popullit-masës. Stërmilli u mor me krijimtari letrare, sikundër është konstatuar më lartë, në rend të parë pse besonte shumë në rolin e letërsisë për transformimin e vetëdijes politike, sociale e morale të shoqërisë shqiptare dhe, si pjesëtar i kësaj shoqërie e me aftësi krijuese, ndiente obligim të japë kontributin e vet në këtë aspekt. Kështu, shtyrë nga dëshira që me një tregim të përfshijë më shumë se një problem për të arritur efekt sa më të madh, si shkrimtar i angazhuar, Stërmilli lëroi tregimin me dy motive — tregimin me dy tema paralele njësoj të rëndësishëm dhe me numër të madh personazhesh. Ky element strukturor është karakteristike gati e gjysmës së tregimeve të Stërmillit dhe formon tipin më të rëndësishëm të prozës tregimtare të tij. Megjithatë, në bazë të subjektit të këtij tipi të tregimeve të Stërmillit, ato formojnë tri grupe — grupin e tipit të tregimeve me temë atdheu-dashuria apo dashuria-atdheu, grupin e tipit të tregimeve me temë dashuria-morali apo moralin dashuria dhe grupin e tipit të tregimeve me temë

apo morali-atdheu. Shumica e këtyre tregimeve, që Stërmilli i quante novela, janë tregime të gjata, disa prej të cilave u botuan në vazhdime në dy apo në tre numra të gazetës ose të revistës përkatëse, si p.sh. tregimi „Fati napran”,¹ „Zemra që lëngojnë”,² „As për mue, as për ju”,³ „Dëshira e shokut”,⁴ „Lulkuqja”⁵ etj.

Tipi i tregimeve me dy tema (motive) të Stërmillit dallohet nga tipat e tjerë të tregimeve të këtij autori edhe me numrin e madh të ngjarjeve, të përjetimeve të personazheve kryesorë të lidhur me të dy temat në mënyrë gati të barabartë. Përndryshe, të gjitha tregimet e Stërmillit, si ato me dy motive, ashtu edhe tregimet e moralit, të atdheut e të dashurisë e marrin subjektin nga jeta e dibranëve dhe e banorëve përreth Dibrës, kurse koha e zhvillimit të ngjarjeve është kryesisht viti 1913, atëherë kur shumë dibranë e banorë të rrethinës së Dibrës u detyruan t'i lëshojnë trojet e tyre. Personazhet e shumicës së tregimeve të Stërmillit janë të reja e të rinj që kanë dy probleme njësoj të mëdha e të rëndësishme. Këto probleme të tyre janë atdheu e dashuria, zgjidhja e të cilave qëndron në lidhje të ndërsjellë. Te tregimet me temën e atdheut e me temën e dashurisë është vështirë dhe gati e pamundur të hetohet se cila nga këto dy tema është më kryesore — atdheu apo dashuria. Një gjë është e qartë, realizimi i dashurisë, në rastet më të shpeshta, varet nga përmbushja e detyrës patriotike e personazhit, që gjendet në pozitë dhe e ka për detyrë ta bëjë këtë. Por, meqenëse realizimi me sukses i detyrës patriotike është gati i pamundshëm për shkak të luftës së pabarabartë, së bashku me dështimin në fushën e betejës patriotike, dështon edhe dashuria.

Personazhet e tregimeve të Stërmillit kanë motiv të fortë për të luftuar. Para vetes kanë çështjen e vendlindjes, çështjen e atdheut dhe të dashurisë, prandaj luftojnë në mënyrë vetëmohuese, meqenëse, siç janë të bindur, po s'qe i lirë — s'ka dashuri, po deshe dashuri — duhet të jeshë i lirë, motive këto dy herë të mjaftueshme për të cilat lypset flijuar jetën. Është pohuar më lart se tregimet e Stërmillit kanë shumë personazhe dhe gati gjithmonë nga dy prej tyre janë personazhe kryesore — një e re dhe një i ri. Atëherë kur në një tregim, përveç numrit të madh të personazheve, është vetëm një personazh kryesor, ai është vajzë ose grua

¹ Stërmilli, Haki, *Fati napran*, te „Koha” (Romë), 5.XI.1924, f. 57.

² Stërmilli, Haki, *Zemra që lëngojnë*, te „Koha” (Romë), 16.VIII.1942, f. 30.

³ Stërmilli, Haki, *As për mue, as për ju*, te „Dajti” (Tiranë), 18 e 26.II.1924, f. 2.

⁴ Stërmilli, Haki, *Dëshira e shokut*, te „Dajti” (Tiranë), 8 e 11.III.1924, f. 2.

⁵ Stërmilli, Haki, *Lulkuqja*, te „Dajti” (Tiranë), 28.III. e 11.IV.1924, f. 2.

(shqiptare), fatin tragjik të së cilës Stërmilli e përcjell gjatë gjithë krijimtarisë letrare. Këtë e bën Stërmilli me qëllim që t'i sugjerojë lexuesit të mendojë për fatin e vajzës-gruas shqiptare.

Stërmilli i vendos personazhet e tregimeve të veta në aso rrethanash jetësore që kanë vetëm një rrugë me zgjidhje alternative. Ato gjenden në pozitë që nuk lejon kthim prapa dhe kjo gjendje eliminon luhatjet eventuale, prandaj, personazhet e Stërmillit shkojnë deri në fund dhe rrugës për në cak, rëndom, vdesin-vriten e fare rrallë mbesin të jetojnë për të vdekur vazhdimisht — çdo ditë nga pak.

Personazhet e tregimeve të Stërmillit janë njerëz të rëndomtë, por me vetëdije të lartë patriotike e me koncepte të qarta, e do të thoshim, edhe të drejta për dashurinë e për jetën bashkëkohore. Ato sikur kanë dalë nga një kurse, nga një shkollë e përbashkët ku kanë mësuar për çështjen e atdheut dhe kanë formuar botëkuptim unik e të drejtë mbi dashurinë, prandaj janë mjaft uniformë. Kjo „shkollë” apo ky „kurs”, nëpër të cilën sikur kaluan personazhet e tregimeve të Stërmillit, është jeta e rëndë që e jetuan të parët dhe vetë personazhet e prozës tregimtare të stërmillit. Përvoja jetësore i mësoi dhe i kaliti moralisht, i bëri të fortë, por jo edhe aq as të triumfojnë. Ata u bënë të fortë e të vetëdijshëm për të vuajtur, për të vdekur, për t'u vrrarë për çështjen e atdheut, për dashurinë e pakurorëzuar. Stërmilli nuk i vuri personazhet e tregimeve të veta në rrethana që u mundësojnë fitore, duke dashur, në këtë mënyrë, t'i qëndrojnë sa më afër realitetit jetësor, i cili, në hapësirë e në një kohë të caktuar, qe i hidhur. Duke u vënë në pozita mundëse-kapituluese, ato shpesh janë të hutuara, pa nisjativë dhe presin fundin e ngjarjes pa qenë të zotët të ndikojnë në rrjedha të saj. Këto personazhe rëndom janë emigrantë të ikur nga Dibra apo nga rrethina e saj e të vendosur në Elbasan, në Tiranë, në Durrës ose në ndonjë qytet apo vendbanim tjetër të Shqipërisë, prandaj kanë edhe një brengë tjetër, kanë mallin e dhembjen për vendlindjen që e kanë lënë të djegur e të pushtuar. Ky mall e kjo dhembje për vendlindje herë i mobilizon e herë i demoralizon personazhet e tregimeve të Stërmillit dhe sa herë që aktivizohen, stimulohen nga dashuria. Vajza e djali nuk mund të martohen, nuk duan të martohen pa e kryer detyrën ndaj vendlindjes, kështu që sendërtimi i dashurisë kushtëzohet dhe vetë dashuria merr edhe një dimension tjetër. Në qoftë se të dy dashnorët kanë emigruar, vajza e kushtëzon martesën dhe kërkon prej të dashurit, që rëndom është e fejuar me të, të kthehet në Dibër dhe atje të shpaguajë vëllanë apo prindin e vrrarë, qofshin ata të djalit ose të vajzës, apo të shkojë atje dhe së bashku me patriotët e tjerë të luftojë për çlirimin e Dibrës dhe për ta merituar dashurinë. Nëse e dashura gjendet në Dibër apo në rrethinën e saj, i dashuri nis, prapë, për atje — për të luftuar, për ta shpëtuar të dashurën dhe për ta çliruar vendlindjen, por, si rëndom, nuk ia arrin dot

qëllimit. Stërmilli mjaftohet vetëm me paraqitjen e qëllimit (të mirë), të idealit të personazheve dhe me krijimin e ngjarjeve tronditëse, që, zakonisht, nuk janë mjaft bindëse dhe të shumtën e rasteve janë naive. Kur, për shembull, e dashura informohet se i është vrarë i dashuri në luftë për çlirimin e Dibrës, ajo, nga pikëllimi, sëmuret, merr tuberkulozin dhe vdes fare shpejt. Nga pikëllimi merr tuberkulozin dhe vdes edhe i dashuri, nëse ka shpëtuar nga fushëbeteja, kur merr vesh se e dashura, duke qenë gabimisht e informuar se i është vrarë i dashuri, është sëmurë nga tuberkulozi dhe ka vdekur! Kështu, e dashura vdes kur merr vesh se i ka vdekur, ose duke kujtuar se i ka vdekur i dashuri dhe dashnori vdes kur merr vesh se i ka vdekur e dashura. Këso përfundimesh naive e aspak bindëse janë karakteristikë strukturore e tipit të tregimeve të Stërmillit me dy tema dhe sidomos e tregimeve me temat atdheu-dashuria apo anasjelltas. Këso zgjidhjesh dhe zgjidhje të ngjashme kanë tregimet „Dy zemrat e pabashkueme”,⁶ „As për mue, as për ju”, „Flok’ arta”,⁷ „Mbi vorr të dashnorit”,⁸ „Dëshira e shokut”, „Lulkuqja” e të tjera, që u botuan kryesisht në periodikun e viteve 1923 e 1924.

Grupi i tipit të tregimeve me dy tema, që për subjekt kanë dashurinë dhe ndonjë nga normat morale të shoqërisë shqiptare, u botua në periodikun e viteve 1942—1943, përveç tregimit interesant „Tinzitë e gozhdës”,⁹ që u botua më 1923. Tregimet kryesore të këtij grupi janë: „Atij që më trathtoi”,¹⁰ „Fati napran”, „Zemra që lëngojnë”, „Përsëri asaj që më trathtoi”,¹¹ „Zemra të flijueme”,¹² „Fatushja”,¹³ „Tinzitë e gozhdës” etj.

Dëshuria në tregimet e Stërmillit konceptohet si kategori morale, si virtyt njerëzor, si instrument që përcakton karakterin dhe moralin e njeriut, prandaj, duke e parë dashurinë si kategori morale, personazhet e tregimeve të Stërmillit janë shumë të ndjeshme kur ndonjëri prej tyre e keqpërdor atë. Dashuria formon familjen, dashuria krijon harmoni familjare, dashuria shton kombin,

⁶ Stërmilli, Haki, *Dy zemrat e pa bashkueme*, te „Afrimi” (Vlorë), maj 1924.

⁷ Stërmilli, Haki, *Flok’arta*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), 1.XII.1924, f. 3.

⁸ Stërmilli, Haki, *Mbi vorr të dashnorit*, te „Shtypi” (Tiranë), 11.II.1923, f. 2.

⁹ Stërmilli, Haki, *Tinzitë e gozhdës*, te „Elbasani” (Elbasan), 12.IX.1923, f. 1—2.

¹⁰ Stërmilli, Haki, *Atij që më trathtoi*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), 1.VIII.1942, f. 4.

¹¹ Stërmilli, Haki, *Përsëri asaj që më trathtoi*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), 1.XI.1942, f. 7.

¹² Stërmilli, Haki, *Zemra të flijueme*, te „Koha” (Romë), 14.I.1943, f. 36.

¹³ Stërmilli, Haki, *Fatushja*, te „Vatra shqiptare” (Tiranë), 1943, nr. 33—34, f. 5—6.

dashuria rrit njerëzimin; mandej, dashuria stimulon njeriun për punë, dashuria e bën të lumtur jetën, i jep kuptim asaj — janë këto persiatjet e personazheve të tregimeve të Stërmillit. Duke parë dashurinë në këtë funksion, personazhet e tregimeve me dy tema, që për subjekt kanë dashurinë dhe ndonjë nga normat morale, e shohin atë si mit që duhet të respektohet, të nderohet, të adhurohet si një nga kategoritë më të larta të moralit njerëzor. Prandaj, dashuria për interes dhe tradhtia e dashurisë konsiderohen si mëkatet më të rënda morale. Sanija e tregimit „Atij që më trahtoi” e sheh të pamoralshme dhe në aspektin kombëtar të dëmshme tradhtinë që i bëri ish i dashuri. Ajo tashti është tërhequr në gëzhhojën e mendimeve pa perspektivë duke qenë e bindur se jeta s’ka më kuptim për të, ngase „s’ka të drejtë” të dashurojë dhe s’mund të dashurojë për së dyti dikë tjetër, kurse pa dashuri nuk mund të organizohet jeta. Dhe, po qe se ndodh e pabesueshmja që të dashurojë ndonjë djalë tjetër, ajo është e bindur se do të bënte punë të pamoralshme, prandaj nuk dëshiron të mëndojë për dashuri të dytë, frikohet prej saj, meqë në këtë mënyrë do të shkelte nderin e dashurisë së parë dhe do të merrte nëpër këmbë moralin, pa të cilin „s’ka kuptim jeta”. Përveç bindjes se s’ka të drejtë të dashurojë për së dyti, Sanija është e bindur se nuk ka më fuqi për dashuri, se fizikisht dhe moralisht nuk është e denjë, prandaj „ia ka ënda” të vuajë dhe me vetëdije e pret vdekjen t’i vijë si shumë vajzave të tjera të tregimeve të Stërmillit.

Stërmilli hetoi forma të ndryshme të cenimit të moralit në raport me dashurinë, aktorë të të cilit nuk janë vetëm djemtë. Në raste mjaft të shpeshta, normat e moralit shoqëror në lidhmëri me dashurinë shkelen edhe nga vajzat. Këtë fenomen Stërmilli e sheh edhe si nismë të emancipimit të vajzës (femrës) shqiptare, por në këtë rrugë ajo gabon duke mos qenë në gjendje t’i shohë anët negative që vijnë së bashku me civilizimin. Rrezja e tregimit „Përsëri asaj që më trathtoi” vepron ngjashëm me Tahirin e tregimit „Atij që më trathtoi”. Hashim Stërgjyshi, i tradhtuar nga e dashura e tij — Rrezja, vuan shpirtërisht dhe ka humbu dëshirën për jetë, prandaj „vorri ashtë strehë e lakmueshme për dashnorin e mjerë që qan e vajton”.¹⁴ Ai e dëshiron këtë pse konsideron se i është marrë nëpër këmbë dashuria, lumturia, burrëria, krenaria e morali, pa të cilat „ashtë e turpshme jeta”.

Bujaria, burrëria, besnikëria, dashuria dhe karakteri i fortë janë strumbullarët e njërit nga tregimet më të mira të Stërmillit, të tregimit „Zemra që lëngojnë”. Autori synon dhe, do të thoshim, ia arrin me sukses që këto kategori të moralit shqiptar, si i quante shpesh Stërmilli qoftë në shkrime, qoftë në biseda me shokë, t’i ngre në norma morale kombëtare, t’i theksojë si veçori karakteristike të popullit shqiptar. Salë Mani i Lukanit të Matit ia

¹⁴ Stërmilli, Haki, *Përsëri asaj që më trathtoi*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), 1. XI. 1942, f. 7.

hap zemrën mikut (mysafirit), e nderon, e respekton dhe, pasi del nga shtëpia e tij, kujdeset për të deri të arrijë në vendin që dëshiron. Stërmilli arrin t'i përshkruajë me sukses zakonet e familjes malësore shqiptare. Rendi e harmonia familjare, zgjuarsia e anëtarëve të familjes së madhe të Salë Manit, e shprehur gjatë bisedës që „rrjedh si burimi i pastër që del nga rranjët e ahut”, e mahnisin dhe gëzojnë pa masë udhëtarin e ri — Rifat Ulëzën e Dibrës, që atë natë, në rrugë për në Mat, ku do të shërbejë si nëpunës, u ndal për konak te Salë Mani. Bulja, vajza 17-vjeçare e Salë Manit, e rritur në ajër të pastër të malësisë e me qumësht delësh, dashurohet në mysafirin e ri e të bukur dhe zgjon interesimin e tij. Sikundër ndodh shpesh në tregimet e dashurisë të Stërmillit, edhe Bulja e Rifati, në shikim të parë, bien në dashuri. Të nesërmen, mysafiri i ri duhej të përcillej deri në cakun tjetër. Pasi vëllezërit e djemtë e Salës me të gdhirë kishin shkuar në punët e caktuara më parë, Salë Mani, meqë s'mund ta linte mikun vetëm, caktoi Bulen ta përcjellë deri në fshatin tjetër, që ishte mjaft larg. Gjatë rrugës, Bulja e Rifati përjetojnë dramë të vërtetë ndjenjash. Buka nuk mund të shkelet, bujaria e besnikëria nuk mund të merren nëpër këmbë — janë këto bindjet e botëkuptimit moral që i dilnin përpara Rifatit dhe formojnë bjeshkën e pakapërcyeshme në mes të tij e të Bules, në njërën anë dhe „nderi i unazës”, në anën tjetër, meqenëse Bulja ishte e fejuar, që „formonte oqeanin e palundrueshëm „midis dy të rinjve. Salë Mani ia dha vajzën Rifatit që ta përcillte nëpër rrugë të pyjeve e të maleve pa u frikuar se do t'i cenohej morali, meqë vetë ishte i ndershëm, ishte trim, kishte besim në vajzën e vet të edukuar në një familje moralisht të shëndoshë, kishte besim në mysafirin që „i dha bukë e zemër”. Rifati e ruajti moralin e mikut, por e ruajti edhe dashurinë ndaj Bules duke mos u martuar kurrë pse zemra e tij s'ka vend për dy dashuri”, ndërsa Bulen e copëtonte ndërjegjja pasi „zemrën e ka te Rifati e vetëm trupin te burri” me të cilin u desht të martohej, pasi „s'mund të prishet unaza” dhe kështu vazhdojnë” të lëngojnë dy zemra”. Në këtë mënyrë, Stërmilli i ngriti normat morale mbi ndjenjat dhe, shpesh, sikur pa dashje, i paraqet si vargonj që i mbajnë të lidhura emocionet dhe shkaktjnë vuajtje të përhershme shpirtërore.

Disa nga tregimet me dy tema (motive) Stërmilli i shkroi në formë epistolare, si p.sh. tregimet „Atij që më trathtoi”, „Asaj që më trathtoi”¹⁵ dhe „Përsëri asaj që më trathtoi”. Vajza apo djali, që kanë probleme në dashuri dhe që i mundon çështja e marrjes nëpër këmbë e besës së dhënë, e pastërtisë së moralit, shkruajnë letra të hapura për të shprehur mendimet, pikëpamjet dhe ndjeshmërinë e tyre lidhur me probleme të caktuara. Ata ia drejtojnë letrat ndonjë gazete apo reviste, Radio-Tiranës apo shkrimtarit

¹⁵ Stërmilli, Haki, *Asaj që më trathtoi*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), 15.VI.1942, f. 4.

(Stërmillit) me kërkesë që të publikohen, e jo të dashurit ose të dashurës që kanë tradhtuar dhe kanë shkelur norma morale. Në këto tregime në formë letre flitet për tradhtinë në dashuri, që, së bashku me shkeljen e normave morale, e rëndojnë jetën e personazhit „autor”. Hasan Stërgjyshi i tregimit në formë letre „Përsëri asaj që më trathtoi” i ankohet Stërmillit se e dashura e tij -Rrezja e ka lënë, se ajo po e cenon një traditë të vjetër, siç është „ruajtja e nderit të unazës”, që identifikohet me besën, ndaj së cilës populli ynë, mendon Hasan Stërgjyshi, ka kult. Rreze Drita — ish dashnorja e Hasan Stërgjyshit, do të ngrihet mbi disa norma, që, në rrethana të caktuara, është më keq të respektohen se sa të kundërshtohen. Ajo ka pikëpamje tjetërfare mbi dashurinë në krahasim me ato të të rinjve të tjerë. Një kohë të caktuar Rrezja e dashuron Hasanin, madje fuqimisht, por me kohë i shuhet ajo dashuri dhe largohet prej tij. Këtë sjellje të saj Hasani, që është zëdhënës i Stërmillit, e quan tradhti, shtirje në gjëra të shenjta të moralit kombëtar, kurse Rrezja e konsideron si të zakonshme, si sjellje që ia dikton zemra dhe arsyeja e që është brenda veprimeve njerëzore, kështuqë, sikurse të ishte ndonjë vajzë e emancipuar plotësisht, i drejtohet ish të dashurit „Kur nuk ndiej ma dashuni, pse të rrej ty dhe veten?”. Hasani mbron traditën, kurse Rrezja nuk i nënshtrohet asaj, dëshiron të jetë e lirë. Edhe pse në tregim nuk del e qartë arsyeja se Rrezja largohet nga ish-dashnori, ky tregim flet për shenjat e para të dëshirës së vajzës shqiptare për emancipim, për t’u liruar nga disa norma të ngushta të moralit shoqëror, për ç’arsye e dënon mjedisi, e madje, edhe shkrimtari. Sipas Rrezes, vajza shqiptare nuk duhet të jetë vetëm e fejuar ose vetëm e dashur që mund ta lërë i dashuri apo i fejuari kur të dojë, kur t’i teket, por duhet të jetë edhe e fejuar apo e dashur që mund ta lërë të fejuarin ose të dashurin kur nuk ndien më dashuri për të pa çarë kokën se ç’mund të ndodhë më pas.

Fejesën e bërë me dëshirë të ndërsjellë, Stërmilli e paraqet si kategori morale në marrëdhëniet ndërpersonale e ndërfamiljare, si institucion familjar që nuk bën të cenohet, prandaj shumica e personazheve të tregimeve të tij e respektojnë dhe kanë kult ndaj saj. Megjithëkëtë, kjo kategori e mitizuar e moralit shoqëror shpesh merret nëpër këmbë dhe zakonisht këtë e bëjnë të rinjtë (bijt e bijat) e familjeve të pasura ose etërit apo vëllezërit më të mëdhenj, por të pahair, të tyre. Fshatarët e qytetarët e varfër, zejtarët, që me nderë e sigurojnë jetën, i qëndrojnë besnikë fejesës dhe nuk duan e nuk lejojnë që për interes (material) të prishet fejesa. Megjithëkëtë, prishja e fejesës, madje për motive të ulëta e të pamoralshme, është realitet jetësor në shoqërinë shqiptare të viteve midis dy luftërave botërore. Këtë fenomen Stërmilli e sheh si dukuri me pasoja të rënda shoqërore, prandaj, përmes narracionit autorial e ndërhyrjeve të ndryshme e dënon dhe e vlerëson si gjë të pamoralshme e të rrezikshme. Për shkak të kësaj du-

kurie ,që Stërmilli do ta kualifikojë si plagë shoqërore bashkëkohore, pasojnë vuajtje shpirtërore, sëmundje nga pikëllimi, vrasje e vuajtje të gjata burgu. Këtë dukuri shoqërore Stërmilli e transponon me sukses në tregimet „Fati napran” dhe „Zemra të flijue-me”. Këto, për interes material, prish fejesën e motrës-Linës me Stavrin dhe i rrënon ëndrrat e tyre për të formuar një familje të shëndoshë. Ai e rifejon të motrën me një ish-emigrant shqiptar të kthyer nga Amerika, që, përveç moshës së shtyrë, kishte edhe shumë dollarë. Stavrit i rrëmbehet dashuria dhe i cenohet nderi. Ai, gjatë jetës së tij, pati edhe vështirësi të tjera dhe shumë të rënda. Ky ngarkim i personazheve me probleme të shumta e të llojllojshme është veti strukturore e tregimeve të Stërmillit. Stavrit, nga skamja i sëmuren dhe i vdesin prindërit që në fëmijëri duke e lënë me një vëlla edhe më të vogël. Ai i varros prindërit me duart e veta të njoma dhe qëndroi stoikisht, madje, edhe pse fëmijë, kreu punë të rënda „e nënçmuese” për të ushqyer me nder vëllanë e vogël e vetveten. Të gjitha këto vështirësi i përballon, por grabitjen e dashurisë dhe shkeljen e nderit nuk i duroi dot, prandaj, ai Stavri i urtë, i sjellshëm e i ndershëm e humb arsyen dhe duke mos qenë në gjendje të çmojë drejt „mëkatin” e Linës, shtie në të, në shqiptarin e Amerikës dhe, duke dashur të bëjë vetëvrasje, meqë nuk desh të jetojë i turpëruar e pa dashuri, plagosi vetveten.

Prishjen e fejesës për shkak të ndërhyrjes së faktorit të tretë Stërmilli e sheh si dukuri, e jo si rast, me pasojat tragjike. Për shkak të prishjes së një fejese, pse, dëshiron faktori i tretë, që zakonisht është më i fuqishëm, pasojnë një, dy, tri vrasje, një ashtu dy, tri etj. plagosje, një dy, tri etj. bugime e shumë vuajtje shpirtërore. Në raste më të shpeshta, prishja e fejesës bëhet pa dëshirën e të fejuarve, të cilët, pastaj, bëhen vrasës, burgosen ose sëmuren nga pikëllimi dhe vdesin. Rëndom, i fejuari është vrasës dhe mandej i burgosur ose njëherë i burgosur e mandej vrasës dhe prap i burgosur, kurse e fejuara — e martuar me përdhunë, eventualisht e plagosur dhe gjithmonë me vuajtje të rënda shpirtërore që përfundojnë me sëmurje nga tuberkulozi e me vdekje.

Stërmilli e dënon faktorin e tretë që bëhet shkaktar për prishjen e fejesës, kurse e arsyeton krimin me qëllim që të ruhet nderi e dashuria — të mos cenohen ato. Përmes narracionit në vetën e parë ose përmes narracionit autorial, Stërmilli e shfaqësin dorasin, e këtille, duke konsideruar se për ruajtjen e nderit dhe për dashuri të vërtetë, vrasja është krim i domosdoshëm dhe pastrim i së keqes. Ndërhyrja e personit të tretë për prishjen e fejesës bëhet aq më e rëndë kur dihet se fejesat bëhen me pëlqimin e të rinjve. Në tregimet e Stërmillit nuk ndodh që fejesa (e parë) të bëhet „në djep” apo pa dëshirën e të rinjve, kurse fejesat e dyta (pas prishjes së fejesës së parë) bëhen për interes të faktorit të tretë, prandaj shkaktojnë tragjedi. Fejesën e Salës e të She-

gës të tregimit „Zemra të flijueme” e prish Meti, bir i një pasaniku, një i ri i pispillosur që bredh rrugëve dhe nxit ngatërresa. Për t’ia arritur qëllimit, Meti e provokon Salën duke shprehur ndjenja e dëshira intime për të fejuarën e tij, për Shegën. Meqë Sala nuk mund t’i durojë fyerjet që Meti ia bën Shegës, Sala e sulmon Metin fizikisht aq sa mjafton që ta marrin policën e ta burgosin. Ky ishte qëllimi i Metit, në mënyrë që të lirohet nga Sala për t’iu vardisur lirisht Shegës. Lam Laramani, burrë me karakter të dobët, pranon ta prishë fejesën e të bijës, të Shegës për ta rifejuar dhe martuar me Metin e pispillosur e të pasur. Stërmilli i vë personazhet femra të tregimeve të veta në aso rrethanash të cilat nuk lejojnë kurrfarë mundësie që të ndryshojnë situatën. Ato mund të bëjnë vetëm vetëvrasje dhe për këtë gjë mendojnë shpesh, por prapë nuk vendosin që ta përfundojnë jetën në atë mënyrë, meqenëse më shumë preferojnë vdekjen nga pikëllimi — „vdekjen e bardhë”. Personazhet meshkuj, ato të cilave u bëhen padrejtësi, u cenohet nderi e dinjiteti dhe u rrëmbehet dashuria, krijojnë rrethana dhe ndërmarrin aksione që nuk rezultojnë zgjidhjen e problemit. Ato, zakonisht, hakmerren, vrasin atë që ua merr dashnoren — të fejuarën, atë që është fajtor lidhur me këtë çështje, rëndom babain ose të vëllain e të fejuarës dhe përfundojnë në burg për të vuajtur dënimin dhe për të vazhduar vuajtjen shpirtërore e fizike që shpesh i shpie në çmendje dhe në vdekje, ndërsa Stërmilli e mbyll tregimin me konstatimin „Kështu flijohen zemrat dhe njerëzit në vendin t’onë”.¹⁶ Në këtë mënyrë, Stërmilli e konkretizon këtë dukuri shoqërore dhe konstaton se ka shtrirje me përmasa shqetësuese. Viktima të raporteve jo të shëndosha të mjedisit janë edhe të fejuarit Fatushja e Lami të tregimit „Fatushja”. Edhe pse Stërmilli nuk dëshiron të theksojë më shkoqur se organet e pushtetit, në rend të parë, janë shkaktarë për këso pasojash tragjike, të cilat, përveç problemeve të tjera të shumta ekonomike e arsimore, po e pllakosin shoqërinë shqiptare, nga tregimet e tij shihet se policia, si organ kompetent për pengimin e krimeve të ndryshme, është vetëm spektatore (soditëse) kurrështare e ngjarjeve tragjike dhe në fund, ata që shpëtojnë nga përlëshjet, i merr dhe i burgos për t’u gjetur punë organeve ndjekëse e ndëshkuese. Kështu, pushteti nuk ndërmerr asgjë për të evituar shkakun, por pret fundin tragjik të konflikteve të ndryshme të popullatës. Ç’është edhe më keq, shpesh edhe vetë organet e pushtetit, e sidomos policia, shkaktajnë tragjedi të ndryshme duke u përzier, apo duke cenuar moralin e qytetarëve. Deputeti, kur merr vesh se i fejuari i Fatushes-Lami ka rënë në burg, meqenëse në vetëmbrojtje kishte vrarë një person, i vardiset, kurse Fatushja, për të ruajtur nderin, vret deputetin, për ç’arsye burgoset. Meqenëse pushteti nuk e mbrojti as Lamin e as

¹⁶ Stërmilli, Haki, *Zemra të flijueme*, te „Koha” (Romë), 14.I. 1943, f. 36.

Fatushen, ata u vënë në pozitë obliguese për të mbrojtur nderin e tyre dhe në këtë përpjekje bëjnë krim, vrasin fajtorin-dhunuesin dhe përfundojnë në burg për të vuajtur për njëri tjetrin, por, sipas bindjes së tyre, me ndërgjegje të pastër se e kanë mbrojtur moralin dhe e kanë ruajtur dashurinë.

Stërmilli arrin të kapë disa nuanca interesante të gjendjes psikike të personazheve të shumta të tregimeve të veta. Këtë e realizon mjaft mirë edhe në tipin e tregimeve me dy tema të grupit atdheu-morali apo anasjelltas. Eqrem Vetima i tregimit „Dora e djathtë”¹⁷ gjendet para një problemi të rëndë. Nga plaga që kishin marrë në luftë për të mbrojtur Dibrën, Eqremi i shkaktohet gangrena në dorën e djathtë. Mjekët e një spitali të Vjenës i propozojnë prerjen e dorës së djathtë mbi bërryl. Ky propozim e vë Eqrem Vetimën para një dileme të madhe. Po t’i pritej dora, nuk do të jetë në gjendje të luftojë për çlirimin e Dibrës dhe sikur të mos pranojë prerjen e dorës, frikohet se mos mjekët austriakë do të mendojnë se luftëtari shqiptar është frikacak dhe se, përmes shembullit të tij, do të dyshohet në karakterin e fortë e në trimërinë e shqiptarit, me të cilat krenohej Eqrem Vetima. Ai nuk frikohet se për shkak të dorës së prerë do ta lërë e dashura, meqë kishte besim të madh në Lule Bardhën, meqë, siç ua pohonte shoqëve që e shoqëronin, shqiptarja nuk të lë në ditë të vështira. Stërmilli, kur përmes gojës së Eqrem Vetimës konstaton besnikërinë e femrës shqiptare dhe karakterin e fortë të saj, sikur harron rastet e tjera të transponuara në tregimet e veta, kur dashnorja, madje edhe e fejuara e lë dashnorin — të fejuarin pa ndonjë motiv të fortë. Kjo do të ishte gjë e rëndomtë, madje transponim real i jetës sikur në tregimet e tjera, përmes një rasti apo edhe të më shumë rasteve të mos bëheshin përgjithësime për karakterin e fortë e moralin e lartë qoftë të vajzës (gruas) apo të djalit (burrin) shqiptar. Përveç ndjenjës së lartë patriotike dhe shqetësimit shpirtëror të Eqrem Vetimës nga droja se të huajt do të ndryshojnë bindjen për burrërinë, për karakterin e fortë e për trimërinë e shqiptarit, në tregimin „Dora e djathtë” Stërmilli heton edhe një element shumë të rëndësishëm, sidomos në rrethana lufte. Solidariteti për grumbullimin e mjeteve financiare, që nevojiten për shërimin e luftëtarit të plagosur — të Eqrem Vetimës, e mban të ngritur lart moralin e luftëtarëve të tjerë dhe të vetë Eqremi se në raste të nevojshme nuk do të mbesin në mëshirën e fatit. Në këtë mënyrë, Stërmilli e ngrit solidaritetin në faktor vendimtar për rezistencë të mëtejshme e të denjë dhe për optimizëm në fitore, madje në të gjitha fushat e jetës.

Siç është konstatuar edhe më parë, për shumicën e tregimeve Stërmilli e merr subjektin nga Dibra dhe, si dëshiron të po-

¹⁷ Stërmilli, Haki, *Dora e djathtë*, te „Elbasani” (Elbasan), 19. IX. 1923, f. 2.

hojë shpesh, „ngjarjet janë ndodhi të vërteta”, zhvillimin e të cilave, si dibran që ishte, ose e kishte parë, ose kishte dëgjuar për to nga njerëz të njohur. Përveç kësaj, disa njerëz të njohur, disa bashkëvendës të emigruar në qytete të Shqipërisë i tregonin Stërmillit ngjarje të ndryshme, të cilat, mandej, i shfrytëzonte për subjekte të tregimeve të veta. I tillë ishte edhe tregimi „Tinzitë e gozhdës” i tipit të tregimeve me dy tema të grupit morali-atdheu. Nazmiu, një bashkëvendës dhe i njohur i Stërmillit evokon kujtime të hidhura nga viti 1913, kur u detyrua të lëshojë vendlindjen — Dibren, meqë kishte vrarë një oficer të ushtrisë okupuese për të mbrojtur nderin e dashnores e të vetin dhe për të dobësuar radhët e ushtrisë kundërshtare. Gozhda, të cilën Nazmiu e mbante në dorë, ruante kujtime të rënda e të paharrueshme. Me të ai kishte vrarë oficerin që ia rrëmbeu lirinë dhe deshë t’ia marrë nëpër këmbë nderin një vajze të re. Stërmilli pati rastin të shfrytëzojë këtë ngjarje interesante e tronditëse dhe të shkruajë një tregim të fuqishëm duke shfrytëzuar sidomos simbolikën e gozhdës, fshehtësinë që ruante ajo, por ai u mjaftua vetëm me paraqitjen e syzheut të tregimit në formë kallëzimi, që mund të shërbejë për transponim artistik të një segmenti të rëndësishëm të jetës së Nazmiut e të dashurës së tij dhe të fatit të një qyteti të tërë.

2. Tipi i tregimit për moralin

Hiq tregimin „Për hir të nderit”,¹⁸ që u botua në vitin 1923, tregimet e tjera të tipit të tregimit të moralit u bouan në vitin 1942 e 1943 dhe kjo nuk ndodhi rastësisht. Pas një pauze prej dy dekadash, Stërmilli paraqitet përsëri me tregime dhe pikërisht në ato vite kur shumë norma morale, sipas mendimit të tij, cenoheshin pa mëshirë. Sikundër dihet, janë këto vitet kur në Shqipëri ndërroheshin okupatorët dhe shërbëtorët e tyre, kur dinjiteti dhe morali shoqëror kishin mbetur në fatin e stihisë ose shkeleshin nga persona e kapadainj të ndryshëm, që është pasojë e mungesës së ruajtjes së rendit shoqëror, i mosrespektimit të ligjeve edhe ashtu të gjymta nga ata që e kishin për detyrë të ruajnë moralin-nderin e individëve e të shoqërisë. Ky realitet e shqetësoi Stërmillin dhe e nxiti të shkruajë një numër relativisht të madh tregimesh, si p.sh. „Cila je?”¹⁹ „Kangë e ... vajë”,²⁰ „Të fejuemit”,²¹

¹⁸ Stërmilli, Haki, *Për hir të nderit*, te „Tomori” (Tiranë), 7.II.1923, f. 3.

¹⁹ Stërmilli, Haki, *Cila je?*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), I.X.1942, f. 6.

²⁰ Stërmilli, Haki, *Kangë e ... vaj*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), 15.XI.1942, f. 5.

²¹ Stërmilli, Haki, *Të fejuemit*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), 1.IX.1942, f. 7.

„Dy anmiqt”,²² „Zemra të dënueme”,²³ „Rrebeshi”,²⁴ „Zi e ma zi”,²⁵ etj., me qëllim që përmes prezentimit të shembujve negativë të kontribuojë për komprometimin e tyre, t’i zhveshë e t’i dënojë ato sjellje që shkaktojnë dhembje shpirtërore e fizike. Këto tregime kritikojnë individët, degjenerimin moral të tyre dhe sistemin politik-shoqëror që nuk kujdesej për ruajtjen e moralit shoqëror, për të vënë rend e rregull në shoqëri.

Si edhe në tregimet e tjera, edhe në tipin e tregimeve për moralin personazhet kryesore janë vajza e djali të fejuar apo të dashuruar dhe personazhet e treta që rëndom ua ngatërrojnë punët të fejuarve dhe u shkaktojnë dhembje shpirtërore e fizike dhe vdekje. Hila i tregimit „Zemra të dënueme”, duke u mbrojtur, e godet dhe e lëndon një person që e kishte fyer e sulmuar fizikisht pa arsye dhe për këtë, në vend që të dënohet ai që e fyejti dhe e sulmoi i pari, Hila dënohet me pesë vjet burg. Lilës, të fejuarës së Hilës, i vdesin prindërit nga tifoja. Meqë ishte e varfër, ajo u detyrua të punojë si shërbëtoreshë te pasanikët. Për shkak të shantazheve, Lila u detyrua të ndërrojë shumë zotërinj e shumë qytete (Shkodër, Tiranë, Durrës e Elbasan). Korrupcioni e degjenerimi moral dhe bukuria e Lilës qenë shkaktoreshë që ajo të bredhë prej një pasaniku te tjetri e prej një qyteti në tjetrin. Këtë e bëri për të ruajtur nderin, për të mbajtur besën që i kishte dhënë të fejuarit, i cili e vuante burgun pa faj. Lila nuk kishte mbrojtës, prindërit i kishin vdekur, të fejuarin e kishte në burg e vëlla nuk kishte. Kjo rrethanë u dha mundësi pasanikëve ose bijve të tyre ta sulmojnë Lilën për ta dhunuar. Iku Lila herë prej njërit e herë prej tjetrit dhe „shetiti” shumë qytete të Shqipërisë për të mbrojtur nderin. Megjithkëtë, më në fund, Lila pushtohet dhe si rezultat i pushtimit pason letra të cilën ia dërgon të fejuarit në burgun e Tiranës: „... un s’jam ma për ty se u ndrâng e u përlye prehni i em. Nji bishë e egër me fëtyrë njeriu më vrau. Më muar në shtëpi, kinse për shërbëtoreshë dhe më bani me pi nji shurup. Mbas pak minutash nisa me u kotë dhe ma vonë më kllapoi gjumi. Kur u zgjova, nga shurupi dhe nga turtura e asaj kafshe që më kish pushtue, s’qesh e zoja me e kundërshtue, sepse isha mpi e dobësue”.²⁶ Me ndihmën e opiumit, pasaniku e pushtoi Lilën dhe i grabiti gjënë më të shenjtë, atë që e konsideron sinonim të jetës. Kultit i moralit, të cilin e kishte ndërtuar me shekuj shoqëria

²² Stërmilli, Haki, *Dy anmiqt*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), 15.VIII.1942, f. 6.

²³ Stërmilli, Haki, *Zemra të dënueme*, te „Vatra shqiptare” (Tiranë), maj 1943, f. 5, 6, 7.

²⁴ Stërmilli, Haki, *Rrebeshi*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), 16.IV.1943, f. 4.

²⁵ Stërmilli, Haki, *Zi e ma zi*, te „Tomori” (Tiranë), 9.III.1943, f. 3.

²⁶ Stërmilli, Haki, *Zemra të dënueme*, te „Vatra shqiptare” (Tiranë), maj 1943, f. 6.

shqiptare, filloi të rrënohet prej individëve të prishur që s'ia kishin drojën as pushtetit të shthurur. Stërmilli përpiket të depërtojë në botën shpirtërore të Lilës, por nuk sheh më shumë se atë që del prej letrës së saj që ia dërgoi të fejuarit në burg. Hila ka besim të plotë në karakterin e fortë e në moralin e pastër të Lilës, por nuk ka zemërgjerësi që të kalojë mbi atë që i ka ndodhur të fejuarës. Atij i mungon forca morale dhe forca e arsyes për të penguar dyfishimin e tragjedisë së Lilës. Ai nuk mund të ngritet mbi mentalitetin mikroborgjez të çarshisë, prandaj nuk e siguron të fejuarën se edhe më tutje mbetet e fejuara dhe bashkëshortja e ardhshme e tij, kursi, në anën tjetër, betohet: „faji do të ndëshkohet” dhe konkludon: „Ajo asht viktimë, shoqnia asht fajtoare kundrejt saj”.²⁷

Si edhe në tregimet e tjera të Stërmillit, syzheu i tipit të tregimeve të moralit është raporti midis vajzës e djalit dhe ndërhyrja e faktorit të tretë. Rëndom, ky faktor i tretë, i paraqitur në nuanca e në forma të ndryshme, është shkaktar i moskurorëzimit të dashurisë së të rinjve, i cenimit të moralit individual e shoqëror dhe i fatkeqësive e tragjedive të ndryshme. Në vitet 1940, nën ndikimin e huaj, sidomos italian, një numër i konsiderueshëm i rinisë shqiptare filloi t'i shkelë pa mëshirë disa norma morale të respektuara me shekuj. Nën pretekstin e civilizimit e të lirisë së plotë, disa të rinj filluan të bëjnë lista me emrat e vajzave që i kanë mashtruar. Mashtrimi ose cenimi i moralit (nderit) është temë e shpeshtë në tregimet e Stërmillit, ku, zakonisht, djali mashtron vajzën, por ka edhe raste të kundërta. Tregimi „Cila je?”²⁸ trajton një shembull drastik të mashtrimit të vajzave nga djemtë e përdalë. Ky tregim ka një strukturë interesante e origjinale. Një vajzë i lutet Radio-Tiranës që të emetojë tregimin „Atij që më trathtoi”. Shkrimtari, pasi „dëgjoj” përmes radios lutjen e vajzës, interesohet të dijë se cila është ajo vajzë që kërkon emetimin e tregimit të lartpërmendur. Ai bëhet kureshtar të zbulojë qëllimin e vajzës që kërkon ritransmetimin e tregimit „Atij që më trathtoi” dhe arrin të hyjë në shpirtin e saj duke i gjurmuar vuajtjet e shkaktuara nga tradhtia — nga mashtrimi. Dhembja e vajzës së mashtruar, dhembja e shkaktuar nga cenimi i nderit bëhet edhe dhembje e shkrimtarit me kërkesë që ajo të bëhet dhembje kombëtare.

Çështja e nderit (e moralit) është fushë e interesimeve të shpeshta të Stërmillit. Ai vëren se ekzistojnë dy qëndrime diametralisht të kundërta ndaj moralit. Derisa shumica dërrmuese e popullit, sipas hulumtimeve të Stërmillit, e konsideron moralin si virtytin më të lartë dhe e identifikon me jetën, një numër jo

²⁷ *Aty*, f. 7.

²⁸ Stërmilli, Haki, *Cila je?*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), 1.X.1943, f. 6.

i vogël i të rinjve të përdalë, i pasanikëve dhe i njerëzve të pushtetit përdorin mjete e shfrytëzojnë pozita të ndryshme për ta cenuar, për ta shkelur. Kështu, derisa në njërën anë mbrohet morali (nderi), në anën tjetër sulmohet dhe në këtë luftë bien shumë viktimë, shkaktohen shumë tragjedi shpirtërore e fizike. Nikolla i ri e i varfër, për të ruajtur moralin familjar, vret krahinarin që ia kishte dhunuar të ëmën e vejë derisa vetë ishte në shkollë jashtë vendlindjes. Siç thotë edhe titulli i tregimit („Për hir të nderit”), për të mbrojtur nderin familjar, Nikolla bëhet vrasës dhe dergjet në burg meqë pushteti nuk i pengon ata që e „lyejnë me baltë fëtyrën e tjetrit” e në këtë rast, po ai që e ka për detyrë të mbrojë moralin individual e popullor, shfrytëzon pozitën dhe „e përlyen prehnin” e Çiles pa krah.

Pasojat tragjike për shkak të cenimit të nderit, shprehimisht për ruajtjen e tij janë të shpeshta në tregimet e Stërmillit. Duke i theksuar pasojat e rënda, vrasjet, plagosjet, burgimet e të tjera të atyre që i shkelin normat morale, nderin e individëve e të shoqërisë në përgjithësi, Stërmilli, si tribun popullor e si pedagog, do të ndikojë që t’i largojë njerëzit nga punët e këqia. Mihali i tregimit „Zi e ma zi” e vret Zinën, të mbesën, pse „e shkeli kurorën” në kohën kur e kishte bashkëshortin në burg. Edhe Jorgji, burri i Zinës, kishte vrarë një person që kishte tentuar t’ia çnjerrëzojë gruan, prandaj dergjej në burg. Kështu, në një tregim të shkurtër, janë ngjeshur dendësisht shumë ngjarje e shumë tragjedi — dy vrasje (jo të menjëhershme) e dy burgime, të gjitha këto për shkak se kishte marrë hov kapadaillëku, kurse pushteti nuk merrte masa për parandalimin e të këqijave, për mbrojtjen e nderit individual e familjar. Ç’është edhe më keq, shpesh plagosen, vriten e burgosen edhe njerëz të pafajshëm për shkak të shkeljes së normave morale nga të tjerët. Për të realizuar qëllimet e ulëta, disa individë montojnë e shpifin rrena të ndryshme për t’ua nxirë jetën të tjerëve. Në këtë mënyrë, alibia ngrihet në nivel të argumentit dhe tjetri dënohet me burgim të gjatë. Kryeplaku (në tregimin „Rrebeshi”) akuzon Leonidhin për vrasje të një personi të tretë me qëllim që pas burgosjes së tij t’ia akuzojë (duke shpifur) bashkëshorten — Marijen për punë të pamoralshme e të shkatërrojë këtë familje të ndershme e të vyeshme. Gjyqi nuk përpiqet të gjejë të vërtetën lidhur me ngjarjen (e trilluar), por verbërisht i beson kryeplakut intrigant e smirëzi dhe merr vendim për të fyer e shkatërruar një familje të ndershme. Në këtë mënyrë, me kësi shembujsh, Stërmilli i heq maskën gjyqit të korruptuar e përfaqësuesve të ndryshëm të pushtetit.

Stërmilli vëren se çështja e moralit, e nderit është çështje shumë e ndieshme që më shumë prek emocionet se arsyen. Mjafton një e përngjashme për të nxjerrë një përfundim, një „gjykim” që nuk është rezultat i arsyes, por i emocioneve. Kjo rrjedh ngase nderi është ngritur në mit, në kult, ku arsyeja shpesh nuk

bën punë. Tregimi „Kangë e . . . vajë” na kujton ngjarjen tragjike të poezisë „Kurbeti” të Çajupit dhe të dyja së bashku temën e një përralle popullore të cilën e botoi G. Veiga në *Albanesische grammatik*, Leipzig, 1913, f. 142. Rrema, të cilit emocioni ia kishte ndrydhur arsyen, vret të shoqen dhe kushëririn e saj kur i sheh së bashku në oborr të shtëpisë duke kujtuar se e shoqja (derisa ai gjendej në mal si kaçak) kishte gjetur dashnor dhe në këtë mënyrë i kishte cenuar nderin. Stërmilli, si „bari” i mirë, do ta ruajë popullin nga të këqijat, do t’ia harrë të gjitha ato gjëra që e dëmtojnë, që e pengojnë, që e mundojnë. Ai gjen, krijon ngjarje sa më dramatike pa u kujdesur shumë për kushtëzimin dhe lidhjen logjike të tyre, por duke pasur qëllim të caktuar — evitimin e dukurive negative në shoqërinë shqiptare, ruajtjen e arsyeshme të moralit (nderit) individual, familjar e kombëtar dhe dënimin e atyre që „çojnë dorë” kundër tij.

Tradhtinë, si vetinë më të dobët të njeriut, si kategori të ulët morale, Stërmilli e dënon, e komprometon në shumë krijime letërore si edhe në tregimin „Asaj që më trathtoi”, që njëherësh është edhe tregim i dashurisë apo i tipit të tregimit me dy tema (motive)-morali-dashuria. Ky tregim është interesant edhe për një element tjetër, që hasim aty-këtu edhe në ndonjë tregim tjetër. Stërmilli, qoftë në fillim apo në mbarim të ndonjë tregimi, ose përmes të ndonjë fusnote, do t’i informojë lexuesit se ngjarja e tregimit të caktuar është e vërtetë, e jo e trilluar dhe, në këto raste, prej dy personazheve kryesore, personazhi mashkull është vetë. Këtë Stërmilli e bën ngase nuk dëshiron të zërë ngoje emra individësh të caktuar nga droja se mund të mos dëshirojnë, prandaj e merr vetveten për personazh dhe e zhvillon narracionin në vetën e parë. Në tregimin e lartpërmendur zbulohet karakteri i luhatsëm, i dobët i një vajze e cila, për interes material, heq dorë nga dashuria, e tradhton dashnorin, në këtë rast shkrimtarin (Stërmillin) dhe e lë të vuajë, por, njëherësh, damkos vetveten, prandaj të gjithë e shikojnë me përbuzje, që është qëllimi i Stërmillit — dënimi i tradhtisë.

Ngatërresat në mes të individëve dhe në mes të familjeve, që shpesh përfundojnë me ndrydhjen e ndjenjave e të dëshirave dhe, që është edhe më keq, me tragjedi, pas të cilave pason hakmarrja, shihen si gjëra të padenja për njeriun, si veti të karakterit të dobët, të njeriut jo stabil e të paarsyeshëm. Hakmarrja, sipas Stërmillit, nuk është vetëm e keqe në aspektin social, por edhe e keqe, në rend të parë, në aspektin moral. Raportet e këqija ndërfamiljare, që i bien ndesh burrërisë, zemërgjerësisë e gatishmërisë për të falur gabimin, meqë „ma trimni asht me falë se me vra”, trajtohen në tregimet „Dy anmiqt” e „Të fejuemit”. Kjo temë është e njohur nga letërsia popullore dhe e shfrytëzuar edhe nga Shëkspiri shumë vjet më parë, por në një mënyrë tjetër dhe me efekt tjetër. Në stilin e vet, Stërmilli krijon skena moralizuese. Sala e

Mani, dy të rinj të tregimit „Dy anmiqt”, dashurojnë kushërirat e njëri-tjetrit, ndërsa familjejt e tyre ishin në armiqësi, midis të cilave kishte edhe vrasje. Për pajtimin e familjeve të armiqësuar nevojitej motiv i fortë, i cili ekzistonte, por duhej të theksohej, të bëhej më i dukshëm — të ngritej në virtyt, në faktor moral. *Falja* burrërore e fyerjes dhe sidomos e gjakut cilësohet si veti e karakterit të fortë, e moralit të lartë, si trimëri e fisnikëri. Familjet e Salës e të Manit u sollën para problemit: të falin e të „stolisen” me virtyt të lartë moral, apo të vazhdonin armiqësinë që i zhveshte moralisht dhe u sillte viktima të reja. Në këtë luftë motivesh dominon arsyeja, kështu që familjet e armiqësuar i shtrijnë dorën njëra-tjetrës. Për këtë vepër të madhe, përveç motivit moral, rol të rëndësishëm luajnë edhe dy të rinj — Sala e Mani, të cilët, si rëndom, duan të jenë dhe janë më tolerues, më përparimtarë. Si shumë tregime të tjera të Stërmillit, edhe tregimi „Dy anmiqt” i përngjet furtunës e shtrëngatës me shi e me breshër, por që kalon shpejt e mandej kthjellet dhe nxen dielli i këndshëm. Kështu, familjet e armiqësuar pajtohen, Sala e Mani martohen me të dashurat e tyre e mandj vazhdon jeta e qetë, e këndshme — ashtu qysh më shumë dëshiron shkrimtari se sa që rëndom ndodh.

Edhe në tregimin „Të fejuemit” kemi epilog të ngjashëm me atë të tregimit „Dy anmiqt”. Familja e Shukajve pajtohet me familjen e Zeshkanëve e të Gishtahollëve. Në këtë rast, përveç faljes burrërore të plagës, faktor i rëndësishëm është besa. Familja e Zeshkanëve tmerrohet nga alibia (që i kurdisin) se nuk e ka mbajtur besën, prandaj detyrohet të sjellë argumente të forta për të dëshmuar se nuk e ka thyer besën e dhënë. Besën dhe fjalën burrërore i shfrytëzon Stërmilli për të arritur efekte të caktuara, ato i përdor në funksion të mirëqenies njerëzore dhe krejt tregimin, të gjitha tregimet në funksion didaktiko-moralizues.

3. Tipi i tregimit për atdheun

Edhe pse çështja patriotike është bashkëtemë e tipit të tregimeve me dy motive (tema) të Stërmillit, pra në shumicën e tregimeve të tij, Stërmilli lëroi edhe tregimin e mirëfilltë patriotik. Tregimet e këtij tipi janë ndër krijimet e para letrare të Stërmillit dhe, njëherësh, më të paarrirat e prozës së tij tregimtare. Stërmilli sikur u ngut të debutojë me tregime patriotike, meqë ende i kishte të freskëta ngjarjet e përjetimet e vitit 1913, kur populli i Dibrës me rethinë, familja e tij dhe vetë shkrimtari u gjendën para një force të madhe ushtarake të borgjezisë së huaj shoviniste dhe, me rastin e një jubileu, që i zgjoi Stërmillit ndjenjën e trishtimit e të mallit — të dhjetëvjetorit të ikjes nga vendlindja, Stërmilli botoi më 1923 tregimet e para me temë patriotike.

Kësaj teme Stërmilli i kthehet edhe më vonë, pas njëzet vjetësh, me rastin e përvjetorit të dytë dhe kur ka përvojë mjaft të madhe në krijimtarinë letrare, por nuk e trajtoi si temë të veçantë — të vetme, por si bashkëtemë me atë të moralit, me temën e dashurisë e me çështje të ndryshme sociale, prandaj tregimet me dy motive (tema) janë më të pasura me ngjarje dhe më interesante për shkak të shumësisë së ngjarjeve në krahasim me tipin e tregimit për atdheun. Si edhe në tregimet e tjera, në tregimet „Andërr e trishtueshme”,²⁹ „Plaku thinjosh”,³⁰ „Lotët e mi”,³¹ „Nji të puthun”,³² „Trimnija e grues shqiptare”³³ e të tjera të tipit të tregimit për atdheun, Stërmilli nuk mundohet shumë të hetojë shkaqet e pasojave, të bëjë lidhjen logjike të ngjarjeve, të motivojë mjaftueshëm të bëmat e personazheve. Ai mjaftohet me paraqitjen e ngjarjeve, me pasojat tragjike të tyre, me ofshamet e me pikëllimin e personazheve për shkak të robërisë së vendlindjes së tyre. Ngjarjet e këtyre tregimeve lidhen me lokalitete të caktuara a me prototipa — me njerëz të njohur dhe me vetë shkrimtarin. Personazhet prototipa të këtyre ngjarjeve, nëse shpëtojnë nga lufta, janë njerëz të demoralizuar, të pikëlluar, të cilët me rastin e ndonjë jubileu apo të ndonjë feste kombëtare e fetare zotohen se do të luftojnë ose nisen për të çliruar vendlindjen apo, së pakut, të afërmit — farefisnin që u kishte mbetur „i mjeruem në vendin e vet”. Sipas shembullit të Shote Galicës, të Tringë Smajlit, të Norë Kelmendit, të Hasimes e të ndonjë tjetre, Stërmilli krijon personazhet femra të tregimeve e të dramave me vetëdije të lartë patriotike. Në „Trimnija e grues shqiptare” Stërmilli krijon tipin romantik të grues shqiptare, krijon tipin e asaj gruaje që rëndom nuk e gjejmë në jetën e viteve kur vendoset ngjarja dhe në fokusin ku zhvillohet ajo edhe pse shkrimtari pretendon të trajtojë personazhe e ngjarje autentike. Feridja, pasi i këshilloi fëmijët e mitur (njëri 7 e tjetri 8 vjeç) si të sillen dhe kërkon prej tyre që kur të rriten të luftojnë për Dibrën dhe për t’ua marrë hakun prindërve, niset për në luftë si amazonë e vërtetë. Stërmilli nuk jep kurrfarë shpjegimesh se si u pajis Feridja me atë vetëdije aq të lartë patriotike, si u ngrit ajo mbi shoqet e veta për të shërbyer si shembull patriotizmi e trimërie jo vetëm për femrat, por edhe për burrat. Megjithëkëtë, Stërmilli ka vënë

²⁹ Stërmilli, Haki, *Andërr e trishtueshme*, te „Elbasani” (Elbasan), 27.VI.1923, f. 2.

³⁰ Stërmilli, Haki, *Plaku thinjosh*, te „Elbasani” (Elbasan), 15.VIII.1923, f. 2.

³¹ Stërmilli, Haki, *Nji të puthun*, te „Elbasani” (Elbasan), 17.XI.1923, f. 2.

³² Stërmilli, Haki, *Lotët e mi*, te „Elbasani” (Elbasan), 22.VIII.1923, f. 2.

³³ Stërmilli, Haki, *Trimënia e grues shqiptare*, te „Elbasani” (Elbasan), 10.XI.1923, f. 2.

motiv të fortë para Ferides, të mjaftueshëm për të flijuar jetën. Dibra e robëruar dhe burri i vvarë nga ushtarët e borgjezisë së huaj janë motive që e nisën Feriden për në luftë, motive të denja për të flijuar jetën, aq më parë ku e ka bindur veten se të bijtë, kur të rriten, do t'ia marrin hakun nënës dhe babait. Feridja nuk përpigjet ta vlerësojë realitetin, nuk i studion rrethanat, por hidhet në luftë pa kurrfarë shprese se do të fitojë, ose, së pakut të shpëtojë pa u vvarë. Aksioni i saj është baraz me vetëvrasje. Stërmilli do ta paraqesë Feriden si vetëflijuese, si kamikaze që do të vritet për ideal, për atdhe pa i interesuar se a mund të shpëtojë e gjallë nga lufta apo jo. Feridja e tregimit „Trimnija e grues shqiptare” dëshiron t'i tregojë borgjezisë okupuese serbe se nuk mund ta durojë robërinë e vendlindjes, se ka vendosur, t'ia marrë hakun burrit dhe se këto arrihen vetëm duke luftuar e duke flijuar jetën. Mandej, me shembullin personal, Feridja është e bindur se do të ndikojë te bashkëvendësit që të luftojnë për çlirimin e Dibrës, prandaj shkon me dëshirë në luftë dhe, jo bindshëm, futet midis ushtarëve, ku, pasi hakmerret, vritet në mënyrë naive.

Me tregimet patriotike, Stërmilli dëshiron të japë një dokument letrar për ngjarjet e vitit 1913 në Dibër. Tregimi „Një të puthun” ka për subjekt luftën që u zhvillua më 16.IX.1913, në të cilën, përveç të tjerave, prej pesë vëllezërve, vriten katër duke mbrojtur Dibrën dhe shpëton vetëm një, më i vogli — Rizai për t'u kujdesur për fëmijët jetima të vëllezërve të rënë dëshmorë dhe për të shartuar në ta ndjenjën e dashurisë, të respektit e të sakrificës për qytetin e lindjes e për prindërit e rënë. Tregimet e tipit për atdheun lidhen me një lokalitet të caktuar. Këto tregime u shkruan pas vitit 1920, atëherë kur shteti i ri shqiptar qëndronte më i sigurt në këmbët e veta, kështu që Stërmilli ende nuk e shihte rezikun e tij nga jashtë. Atij i interesonte dhe i dhembsej Dibra e tij që shtypej nga borgjezia shoviniste serbo-madhe, i dhembsej populli i Dibrës, në të cilën, përveç shqiptarëve, jetonin edhe maqedonasit, që persekutoheshin në forma të ndryshme. Por, as fati i Rizasë, i cili me bashkëshorten, me të ëmën, me nipa e me mbesa dhe me të vejat e vëllezërve të vvarë kishte emigruar në Shqipëri, nuk ishte më i mirë se i dibranëve të robëruar. Me gjithë ndihmën solidare të popullit të Elbasanit, ku ishte vendosur familja e madhe e Riza Gropës, familja e dëshmorëve filloi të shuhet. Skamja e sëmundja (tifoja) i morën të gjithë anëtarët e familjes së Gropajve, përveç Bardhyllit të vogël (dyvjeçar), që nuk e kuptonte tragjedinë e jetës dhe e puthte të ëmën e vdekur duke kujtuar se flinte. Bardhyli mbeti jetim dhe u rrit nën kujdesin e popullit të Elbasanit jo për të jetuar, për të gëzuar jetën, por për të kryer obligimin, për të shpëtuar dëshmorët dhe për të çliruar Dibrën. Emigrantët dibranë Stërmilli i sheh dhe i vë në një funksion të caktuar, në një detyrë të caktuar e të përhershme. Çlirimi i Dibrës është çlirimi i jetës së tyre, prandaj

për këtë ideal vriten, ose, prej mallit për qytetin e lindjes, sëmurën e vdesin.

Stërmilli nuk i sheh diferencat, kundërthëniet në mes të klasës sunduese e të masës së gjerë popullore — shtresës së varfër. Madje, ky fenomen as që i ka interesuar Stërmillit në vitet njëzet. Ai u mjaftua me faktin se Shqipëria ishte shtet i pavarur dhe ndonjëherë luan rolin e agjitorit të tij duke mos e parë mjerimin ekonomik e kulturor të popullit. Me tregimin „Plaku thinjosh” Stërmilli u bë apel fshatarëve që ta duan pushtetin vetëm për arsye se është pushtet shqiptar. Këtë Stërmilli e shpreh përmes një plaku dibran, që si emigrant jetonte në Shqipëri. Atij nuk i bëjnë përshtypje varfëria e sëmundjet në Shqipërinë e viteve njëzet, meqenëse ato i konsideronte si të këqija që nuk çojnë peshë, natyrisht, duke i krahasuar me të këqijat e ndryshme të qytetit të lindjes — Dibrës. Stërmilli zhvillon bisedë personale me personazhin e vet, të cilit, për hir të konspiracionit, nuk ia thotë as emrin. Edhe Plaku thinjosh nisët për në qytetin e lindjes për të luftuar e për t'i shpague fëmijët e rënë dëshmorë. Ruajtja në konspiracion e emrit të Plakut thinjosh dhe e qëllimit të tij derisa të kalojë kufirin tregon se disa nga krerët e borgjezisë shqiptare kishin vënë kontakt me krerët e borgjezisë serbe, se kishin filluar të bashkëpunojnë disa nga udhëheqësit e qeverisë borgjeze shqiptare e të asaj serbe për t'i ruajtur pozitat e interesat e veta, prandaj Plaku thinjosh detyrohet t'i fshehë qëllimet e veta. Si me tregimin „Plaku thinjosh”, ashtu edhe me disa tregime të tjera me temë patriotike, Stërmilli kap disa aksione të vetmuara, gati individuale të veprimtarisë për çlirimin e qytetit të vendlindjes dhe për shpagimin e njerëzve të vrarë dhe, në këtë mënyrë, këto luftëra, këto aksione nuk ngrihen në shkallë përgjithësuese — këmbëtare. Veç kësaj, aksionet që i ndërmarrin emigrantët dibranë nuk mbështeten në gjasa e në baza reale për fitore. Ata shkojnë në luftë gati me vetëdije se nuk do të jenë në gjendje të ndryshojnë asgjë, por me bindje se kryejnë një obligim të rëndësishëm dhe se flijimi i tyre do të ndikojë në edukimin patriotik të brezave të ardhshëm. Kështu, personazhet e tregimeve për atdheun e ndiejnë obligimin e tyre, janë të vetëdijshëm për pozitën në të cilën gjenden dhe se, duke u flijuar për atdhe, krijojnë historinë e popullit të vet.

Disa nga tregimet e Stërmillit kanë pak ngjarje ose nuk kanë fare. Të tilla janë tregimet „Andërr e trishtueshme”, „Lotët e mi” e ndonjë tjetër të tipit të tregimit për atdheun. Në këto tregime Stërmilli evokon kujtime lidhur me ngjarje të caktuara pa i përshkruar ato ose vetëm shpreh ndjenjat personale, shpreh dhembjen shpirtërore për pasojat e rënda nga ngjarjet të cilat lexuesi i di, qoftë nga tregimet e tjera të Stërmillit apo nga burime të tjera. Sido që të jetë, Stërmilli konsideron se lexuesi, në forma të ndryshme, është i informuar për ngjarjet të cilat i kanë lënë mbre-

sa të thella. Veç kësaj, këto tregime, rëndom, nuk kanë personazhe. Kështu, shkrimtari flet në vetën e parë, shpreh gjendjen shpirtërore personale për çështje të rëndësishme kombëtare, një-rëzore e individuale. Në këtë mënyrë, shkrimtari merr pjesë në dhembjen e individëve dhe të një popullate të tërë ndaj së cilës historia qe e pamëshirshme. Në tregimin, për shembull, „Lotët e mi” Stërmilli shpreh dhembjen shpirtërore për shkak të Dibrës e të Kosovës që shtypeshin mizorisht në të gjitha aspektet e jetës nga borgjezia shoviniste serbomadhe. Tregimi është i mbushur me ofshama e me britma, të cilat i përdor shpesh Stërmilli si mjete për shprehje emocionale. Stërmilli është një i pikëlluar i përherëshëm. Atij as festat e ndryshme fetare e kombëtare nuk ia ndryshojnë gjendjen shpirtërore dhe këtë gjendje shpirtërore kërkon ta kenë edhe lexuesit e tregimit të tij dhe i gjithë populli. Kërkesën që i gjithë populli shqiptar të ndjejë dhembje për Dibrën e robëruar, Stërmilli e paraqet edhe në tregimin „Andërr e trishtueshme”, në të cilin shpreh ndjenjën e obligimit moral për të luftuar për çlirimin e Dibrës. Në këtë mënyrë, tregimi „Andërr e trishtueshme”, si edhe tregimi „Lotët e mi”, është më shumë apel i karakterit mobilizues e propogandistik se sa krijim letrar. Tregimi, si thotë edhe titulli i tij, është një ëndërr e rëndë e shkrimtarit si rezultat i preokupimeve të ditës. Aliu, bashkëbiseduesi i tij në ëndërr, e tmeron edhe më shumë shkrimtarin (ndërsa shkrimtari kërkon të tmerohet edhe lexuesi) me fakte të reja të masakrimeve në qytetin e Dibrës. Aliu është një personazh tragjik, një i ri i tmeruar nga lufta, nga masakrimet ndaj bashkëqytetarëve, ndaj prindërve e ndaj të fejuarës, është gjysmë i çmendur që më shumë rrëfen me sy e me pamjen e përgjithshme fizike sesa me gojë. Sytë e tij xixillues kërkojnë obligim nga shkrimtari e nga lexuesi për t'i shpague dibranët e martirizuar, meqenëse vetë është i paaftë fizikisht dhe mentalisht për një angazhim të tillë. Mungesën e fabulës, të ngjarjes, sikundër është rasti në të dy tregimet e sipërpërmendura, Stërmilli e kompenson me filosofim, me meditim dhe me shprehjen e gjendjes shpirtërore — me emocionalitet të personazhit dhe, sidomos, të vetvetes.

4. Tipi i tregimit për dashurinë

Dashuria është, si të thuash, peri i kuq që i përshkon të gjitha tregimet e Stërmillit, prandaj dashuri ka në tipin e tregimeve me dy tema (motive), siç është parë, në tipin e tregimeve të moralit dhe në tipin e tregimeve të atdheut. Në tregimet e këtyre tipave dashuria është ose temë e parë, ose e dytë, ose si plotësim, si nxitje apo pengesë e rrealizimit të ngjarjes, të temës së tregimit përkatës. Prandaj, Stërmilli, sikur edhe te rasti i tregimeve për atdheun, nuk ka tregime të mirëfillta të dashurisë, meqenëse

dashurinë — ndjenjën e dashurisë e sheh si element të përbashkët, si pjesë përbërëse të secilit segment të jetës së njeriut. Megjithëkëtë, Stërmilli shkroi disa tregime vetëm për dashurinë dhe si më të realizuarat do të veçonim tregimet „Lulja Kruetane”,³⁴ „Kobi”,³⁵ „Asaj që më trathtoi” e ndonjë tjetër.

Edhe për tregimet e dashurisë Stërmilli u përpoq të gjejë subjekte që manifestojnë dhe që arrijnë efekte sa më të mëdha emocionale. Ky parim strukturor i shprehur, sidomos, në tregimet e dashurisë, ka bërë që këto tregime të shquhen me notën, me tonin sentimental. Me gjithë dëshirën e përpjekjet, në tipin e tregimeve për dashurinë Stërmilli nuk arrin të zbulojë e të kapë ngjarje aq të rëndësishme të dashurisë, prandaj këtë mungesë përpiket ta plotësojë me dëshirën që të depërtojë në botën shpirtërore, në emocionet e personazheve.

Rrugët e zhvillimit të ngjarjeve në tregimet për dashurinë të Stërmillit janë, zakonisht, ose vetëm me gjemba, ose fare pa gjemba. Ky element strukturor i tregimeve të Stërmillit, në përgjithësi, e sidomos i tregimeve të dashurisë rezulton teknikën bardh-zi dhe cilësinë e krijimit letrar të tij, që, gjithsesi, nuk jep rezultate të dëshiruara artistike. Prandaj, për shkak të këtij koncepti krijues, tregimet e Stërmillit, sidomos ato të dashurisë, janë përplot goditje artificiale të situatave e të ngjarjeve. Shembujt më karakteristikë për të ilustruar këtë konstatim gjenden në tregimet „Lulja Kruetane” dhe „Kobi”. Derisa në njërin prej tyre ngjarja me shumë të papritura zhvillohet pa pengesa dhe përfundon mirë, në tjetrin dalin pengesa, gjithashtu, të papritura, kurse ngjarja përfundon tragjikisht. Faja e Lulja të tregimit „Lulja Kruetane” takohen rastësisht në spital dhe dashurohen, të thuash, rastësisht — dashurohen ashtu siç dashurohen të gjitha personazhet e tregimeve të Stërmillit, në shikim të parë; mandej edhe prindërit e tyre takohen rastësisht në Banjën e Dibrës, ku kishin shkuar të shërohen prej reumatizmit — prej të njëjtës sëmundje!

Dashuria në shikim të parë, dashuria e rastit, që është karakteristikë e tregimeve të Stërmillit, është, sikundër dëshiron Stërmilli të pohojë, rezultat i problemeve të shumta e gjithëfarëshe të personazheve që i ndrydhnin ndjenjat e dashurisë. Këto tregime Stërmilli i botoi në vitin 1942 e 1943, pra në atë kohë të rëndë e me shumë probleme shoqërore e politike. Skamja e vuajtjet e tjera ia vodhën kohën rinisë shqiptare të mendojë edhe për dashurinë. Faja, siç thotë Stërmilli, „kishte lodhje barku, kursre zemra kurrë s’e kishte bezdisë”. Në moshën 21-vjeçare — mjaft vonë, Faja u prek prej dashurisë, kurse shkrimtari, si me dorë, ia hap rrugën, ia eviton të gjitha pengesat me qëllim që ta kurorë-

³⁴ Stërmilli, Haki, *Lulja Kruetane*, te „Tomori i vogël” (Tiranë), 15.IX.1942, f. 2.

³⁵ Stërmilli, Haki, *Kobi*, te „Tomori” (Tiranë), 28.II.1943, f. 3.

zojë dashurinë e personazheve me martesë të lumtur. Edhe pse martesë është qëllimi i fundit i të rinjve të dashuruar të tregimeve të Stërmillit, kjo realizohet fare rrallë. Këta të rinj gjenden para problemeve të shumta dhe kanë detyra të ndryshme paraprahe mjaft të rënda. Ndonjëri prej tyre duhet të luftojë për çlirim e vendlindjes apo për të shpëguar prindërit, vëllanë apo motën të vrarë, dikush tjetër duhet të krijojë kushte të domosdoshme ekonomike apo të evitojë pengesa të tjera ndërfamiljare e ndërnjerëzore dhe vetëm pas kryerjes së këtyre detyrave shumë të rëndësishme e të rënda, të rinjtë e tregimeve të Stërmillit mund të martohen. Por, meqenëse Stërmilli nuk u krijon mundësi të rinjve të tregimeve të veta, nuk krijon rrethana për t'i realizuar detyrat paraprahe, por i vë para problemeve e detyrave që nuk janë në gjendje t'i zgjidhin e t'i kryejnë, dashuria e tyre, rëndom, mbetet e pakurorëzuar. Epilogu i këtyre rrethanave është vrasja, burgosja apo tradhtia e njërit prej dashnorëve dhe vuajtja shpirtërore, ndërsa prej vuajtjes shpirtërore pason sëmurja e vdekja e dashnorit tjetër. Përjashtim nga ky parim strukturor i tregimeve të dashurisë të Stërmillit bën tregimi „Lulja Kruetane” në të cilin çdo gjë zhvillohet siç është më së miri, pa pengesa, sikurse të ishin organizuar të gjitha rrethanat për t'u hapur shteg, për t'u krijuar kushte ideale Fajës e Lules për kurorëzimin e dashurisë së tyre me martesë. Këto rrethana të tregimit „Lulja Kruetane”, që vështirë përkojnë me realitetin, apo nuk përkojnë fare me të nuk ia ngrisin vlerën artistike tregimit; përkundrazi, tregimi del si i goditur artificialisht, si diç që mund të dëshirohet, por, që, zakonisht, nuk është e mundur të ndodhë ashtu.

Antipod i tregimit „Lulja Kruetane” është tregimi „Kobi”, titulli i të cilit flet për epilogun e tij. E përbashkët në këto dy tregime është vetëm dashuria e të rinjve në shikim të parë, kurse zhvillimi i ngjarjeve për sendërtimin e saj është diametralisht i kundërt. Derisa në shumicën e tregimeve të Stërmillit tragjedia ndodh për shkak se njëri prej personazheve ka obligim e ideal për të cilat mund dhe duhet të rrezikohet e të sakrifkohet edhe jeta, në tregimin „Kobi” personazhi vrritet, e humb jetën në rrethana banale e naive, pa kurrfarë ideali. Në këtë mënyrë, Stërmilli e ngrit fatin në nivel të faktorit nga i cili varet përmbushja ose jo e dëshirave, e kërkesave dhe e nevojave. Lulja, e dashura e Cenit (tregimi „Kobi”), duke luajtur me koburen e Cenit vrritet veten rastësisht, ndërsa Cenit, pas kësaj vetëvrasjeje të dashnores së tij i dalin probleme të rënda. Së pari, Ceni e humb dashnorren dhe, së dyti, duhet të agumentojë se nuk ka gisht në vrasjen e saj. Pasi tejkalohen pengesat e shumta dhe krijohet mundësia që Ceni e Lulja t'ia hapin zemrën njëri-tjetrit dhe bëhet i mundshëm takimi i tyre që të sheshtojnë plane për kurorëzimin e dashurisë, doli pengesa tragjike, e cila Lulen e çoi në varr e Cenin në burg, e prej andej, edhe këtë në varr. Ceni nuk pati mundësi, nuk gjeti argu-

mente të „mjaftueshme” e „bindëse” të shfajësohet se nuk është vrasës. Këtu, njëherësh, shihet edhe paaftësia e gjyqit për të zbuluar të vërtetën, shihet neglizhenca dhe mosinteresimi i organeve të pushtetit (hetuesisë, prokurorisë, gjyqit) për problemet e popullit, në njërën anë dhe, angazhimi i pamjaftueshëm i Ceni për të dëshmuar bindshëm të vërtetën lidhur me vrasjen e Lules, në anën tjetër. Ceni, pas vetëvrasjes së Lules, nuk sheh më lumturi në jetë, prandaj jeta në burg nuk i është e rrëndë. Ai tashti ka vetëm një dëshirë — dëshirën që, sikur të kishte mundësi e aftësi, të dokumentojë se nuk është vrasës. Ky është problemi që e mundon — është problemi i ndërgjegjës së tij. Atë e vret ndërgjegjja nga droja se të tjerët, ata jashtë organeve të pushtetit, nuk i besojnë që s’është fajtor, që s’është vrasës. Kështu, dhembja për Lulen dhe frika se e quajnë vasës ia ndrydhin shpirtin dhe ia godasin moralin aq, sa që më shumë preferon vdekjen sesa lirimin nga burgu e jetën pa Lulen dhe me akuzë të rrëndë se është kriminel. Në këtë mënyrë, Ceni e sforcon mendimin e shumë personazheve të tregimeve të Stërmillit se jeta pa dashuri e me akuzë për vepër të pamoralshme është më e rrëndë se vdekja.

Edhe pse tregimi „Asaj që më trathtoi” është zënë ngoje në tipin e tregimeve me dy motive, ai është edhe tregim i dashurisë. Është përmendur në atë tip të tregimeve vetëm për faktin se dashnorja (një vajzë së cilës nuk i dihet emri) nuk ka qëndrim të drejtë ndaj dashurisë, pse pasuria, interesi material ndikoi në dashuri, në ndërrimin e dashurisë, veti kjo që konsiderohet, çmohet si e pamoralshme. Tregimi „Asaj që më trathtoi”, si edhe të tjera, të theksuara më lart, është shkruar në formë letre; njëri nga dy personazhet e tij është autori i tregimit, kures personazhi i dytë është e dashura e tij, emrin e së cilës shkrimtari nuk dëshiron ta publikojë.

Tregimet e Stërmillit, që nuk i kanë dy motive paralele njësoj të rrëndësishme, kanë pak ngjarje. Në to ka më shumë përshkrim ngjarjesh sesa ngjarje, më shumë ka shprehje emocionesh se akcion.

Në tregimet e dashurisë dhe në tregimet me dy motive, ku si motiv i parë apo i dytë është dashuria, e që njëri nga dy personazhet kryesore është vetë autori, flitet vetëm për dashurinë e pafat. Kjo mund të lidhet edhe me një realitet nga jeta e shkrimtarit. Siç dihet, Stërmilli nuk u martua me dashuri. Nën presionin e së ëmës dhe të farefisit, pas dy-tri vjetësh të rezistencës së pasuksesshme, Stërmilli u detyrua të martohet me të vejën e të vëllait më të madh që iu vra në frontin shqiptaro-grek gjatë Luftërave Ballkanike. Tregimi „Asaj që më trathtoi” është shkruar në vetën e parë, është një letër përshkruese e ndjenjës së dashurisë, e gjendjes së rrëndë shpirtërore të shkrimtarit. Veç kësaj, ky tregim është edhe vërejtje atyre që „luajnë” me dashuri, është apel drejtuar atyre që nuk e çmojnë drejt ndjenjën e dashurisë.

Këtë tregim në formë letre Stërmilli ia drejton të dashurës që hoqi dorë nga dashuria e parë dhe e vërtetë, meqë s'kishte koncepte të drejta ndaj saj, prandaj, tregimi është i mbushur me këshilla, me vërejtje e me lutje. Mandej, tregimi është përplot fraza bombastike, klithma e ofshama, është plot deklarata e pohime, plot krahasime e epitete naive, mjete këto të shfrytëzuara më vonë (nën ndikimin e tregimit) nga shumë të rinj në rastet gjegjëse individuale.

Për shkaqe të pamundësisë për të realizuar dashurinë, personazhet e tregimeve të Stërmillit janë të demoralizuara, të pikëlluara. Për to jeta më nuk ka kuptim, prandaj edhe nuk u dhembset, por, megjithëkëtë, ato nuk e duan vetëvrasjen, por, nga pikëllimi, me vetëdije, e presin sëmundjen e nga sëmundja e presin vdekjen. Atyre u pëlqen vdekja e „bardhë” pasi s'duan të bëhen „katilë” të vetvetes.

Veçoritë artistike të tregimit të Stërmillit

Distanca kohore njëzetvjeçare midis botimit të grupit të parë dhe grupit të dytë (1922/23—1942/43) të tregimeve të Stërmillit zgjoi interesimin e hulumtuesit për të hetuar ndryshimet strukturore të tyre. Rezultati i parë i kësaj pune do të ishte konstatimi se dashuria është temë që trajtohet njësoj si në grupin e tregimeve të botuara në fillim të viteve njëzet, ashtu edhe në grupin e tregimeve të botuara në fillim të viteve dyzet. Mandej, çështja e atdheut është temë që trajtohet shumë shpesh në grupin e parë të tregimeve, së cilës Stërmilli nuk i kthehet në fillim të viteve dyzet. Tashti, në këtë kohë, përveç dashurisë, Stërmillit i interesojnë edhe problemet sociale, apo vetëm një segment i problemeve sociale — çështja e moralit shoqëror-kombëtar.

Tregimet e para të dashurisë Stërmilli i botoi në kohën kur ishte në zgrip të kalimit të dajlërisë — në moshën 27-vjeçare, kurse tregimet e dyta i botoi pas shumë peripecive e mundimeve të llojllojshme — pas mbarimit të kohës pesëvjeçare të emigrimit politik nëpër vende të ndryshme të Evropës, pas vuajtjes pesëvjeçare të burgut në Tiranë si desident politik dhe pas këndelljes shëndetësore, meqenëse jeta e rëndë prej emigranti dhe të burgosuri politike ia kishin dobësuar shëndetin — atëherë kur i kishte kaluar të dyzetat e moshës. Ky fakt jashtëletrar ka pasur mundësi të ndikojë në ndryshimin eventual të botëkuptimit të Stërmillit për dashurinë dhe në mënyrën e trajtimit të temës së saj, pra, në strukturën e tregimeve të dashurisë të shkruara — të botuara njëzet vjet më vonë. Kjo të Stërmilli nuk ndodhi. Si në koncept, ashtu edhe në shtjellimin e syzheut, në kompozicin, ato i gjasojnë njëra-tjetrës, mandej gjuha dhe stili i tyre janë sikur të ishin shkruar në të njëjtën kohë, pa kurrfarë ndryshimesh, shprehi-

misht, pa kurrfarë përparimi, pa asgjë të re. Ky konstatim, ndërkaq, vlen edhe për tregimet e tjera dhe e sforcon mendimin se shumicën e tregimeve, apo gati të gjitha, përveç pak tregimeve të moralit, Stërmilli i shkroi në fillim të viteve njëzet, por i botoi në dy periudha me distancë kohore prej 20 vjetësh, atëherë kur për këtë gjë iu krijuan mundësitë.

Strukturën poetike të prozës tregimtare, por edhe të dramave e të romaneve, të Stërmillit e karakterizon sentimentalizmi me elemente të romantizmit e të realizmit. Duke zbatuar metodën e sentimentalizmit në tregimet dhe në veprat e tjera letrare, Stërmilli shpreh pjesëmarrjen e sinqertë në dhembjen, në problemet e rënda e të shumta të popullit të vet dhe mendimet, idetë vetjake. Në këtë mënyrë, sentimentalizmin e Stërmillit e përshkon një frymë e fortë humanitare, aq më parë kur përmes tregimeve nuk shpreh vetëm dhembjen, pikëllimin personal të personazhit, respektivisht të autorit, por synon të shprehë dhembjen e përgjithshme popullore për pozitën në të cilën kanë rënë personazhet e tregimeve të tij, që, gjithashtu, synohet të përfaqësojnë masën e gjerë popullore. Prandaj, tregimet sentimentaliste të Stërmillit dhe veprat e tjera letrare të tij, duke u interesuar për problemet, për dhembjet popullore, demokratizohen e socializohen. Krijimet letrare të Stërmillit u lexuan prej mësuesve, prej nxënësve, prej femrave, prej shëgërtëve (çirakëve), prej zejtarëve, prej nëpunësve, prej të gjithë atyre që dinin shkrim-lexim, fakt ky që është karakteristikë për letërsinë sentimentaliste jo vetëm shqiptare, por edhe më gjerë, prandaj mu këtu shprehet roli demokratik i saj.

Naiviteti, që krijimtarinë letrare të Stërmillit nënkupton ndershmërinë, është veti karakteristike e personazheve të tregimeve dhe të shumë veprave të tjera letrare të tij. Kur këtë fakt e vëmë pranë mendimit të Shilerit se personazhi i veprës letrare duhet të jetë naiv (i ndershëm) e sentimental, atëherë e kemi lehtë të konkludojmë se ky „naivitet” bëhet realitet estetik në tregimet e Stërmillit dhe në shumë vepra të tjera letrare të tij. Sentimentalizmi i Stërmillit nuk inkadrohet në „pikëllimin e shekullit”, por në botëkuptimin mikroborgjez të shoqërisë shqiptare, në moralin e në pikëpamjet e shtresës së mesme shqiptare kryesisht qytetare. Njeriu i thjeshtë e i ndershëm, që jeton në kushte modeste, ai i shtresës së mesme është personazhi më i dashur e shumë i shpeshtë në tregimet e Stërmillit. Ky personazh, rëndom, flet për veten, i rrëfen problemet personale me dimensione gjithëshoqërore, gjithëkombëtare dhe ndonjëherë pa këtë dimension duke shprehur në këtë mënyrë vetëdijen klasore të borgjezisë së dobët tregtare e agrare shqiptare me elemente të theksuara të shoqërisë patriarkale e feudale. Duke bërë zgjidhje sentimentale e shpesh kompromise, që janë format më të realizuara e më efektive të tij, Stërmilli dëshiron të depërtojë në shpirtin e lexuesit, të ndikojë në të, ta bëjë për vete e së bashku me të të luftojë për

evitimin e dukurive negative, të dëmshme të shoqërisë, element ky që e përbën platformën sociale të veprës letrare të Stërmillit. Mandej, duke prekur njëherësh ndjenjën e dashurisë të gërshetuar me ndjenjën patriotike dhe anasjelltas e herë veçmas — këto dy ndjeshmëri të rëndësishme, si dhe pastërtinë morale, Stërmilli do të realizojë, me tendencë të theksuar, rolin edukativ të veprës letrare te lexuesi.

Mendimi i Çernishevskit se fantazia krijon vepra të dobëta gjen shprehje të mirë në disa krijime letrare të Stërmillit e sidomos në tregimet e tij. Sa herë krijon Stërmilli vetëm me ndihmën e fantazisë, tregimi i tij del i dobët, si p.sh. tregimet „Flok' arta”, „Të fejuemit”, „Kobi”, „Lotët e mi”, „Fatushja”, „Andërr e trish-tueshme”, „Zi e ma zi” etj., ndërsa kur i merr ngjarjet nga jeta reale, ngjarjet që lidhen me lokalitete e me persona të njohur, tregimi është më interesant dhe më bindës, si p.sh. tregimet „Për hirë të nderit”, „Zemra të dënueme”, „Cila je?”, „Tinzitë e gozhdës”, „Zemra që lëngojnë” etj. Megjithëkëtë, në rastet më të shumta, ngjarjet e tregimeve të Stërmillit nuk janë bindëse. Ato, rëndom, ndodhin rastësisht dhe zhvillohen të shkëputura njëra prej tjetrës, pa ndonjë lidhje e rrugë logjike. Madje edhe ngjarjet vendimtare, që rezultojnë vrasje apo vdekje në rrethana të ndryshme, ndodhin në mënyrë jobindëse. Shpesh vrasjet kryehen pse është harruar të mbyllet dera apo pse nuk e ka kapur mirë reza e derës grepin, pra nga pakujdesia ose për shkak të bindjes së gabuar dhe për shkak se papritmas krijohen rrethana, bëhen sulme të papritura, të paparalajmëruara. *Dues ex machina* është element i shpeshtë strukturor i tregimeve të Stërmillit për t'i „zgjidhur” shumë probleme të personazheve. Mandej, ngjarjet e mëdha, sidomos vrasjet, kryhen shumë lehtë në tregimet e Stërmillit. Lami, me një të rame me gërshërë mbyt një burrë të zhvilluar, Fatushja e dobët, me një të qëlluar me shishe mbyt një burrë të fuqishëm, kurse Nazmiu me një gozhdë bën mrekullira dhe, ndër të tjera, me të vret (mbyt) një oficer të ushtrisë okupuese që tentoi t'ia dhunojë të dashurën, etj. Në këtë mënyrë, Stërmilli synon të krijojë ngjarje interesante, sentimentale, të cilat, në fakt, janë të pabesueshme dhe shpesh të pamundshme. Kështu, disa tregime të Stërmillit, si p.sh. „Lulja Kruetane”, „Dy anmiqt”, „Të fejuemit”, etj., u përngjajnë, siç është thënë, furtunave e shtrëngatave me shi e me breshër që pushojnë shpejt e mandej kthjellat qielli e nxen dielli. Veç kësaj, në shumë tregime të Stërmillit, sidomos në ato të dashurisë dhe në tregimet patriotike ka uniformizëm, rutinë e stampë, ka situata ontologjike të ngjashme e të përsëritura shpesh, si për shembull vdekja e personazheve nga pikëllimi, nga vuajtjet shpirtërore që i shkakton, sidomos, dashuria e pafat dhe rrethanat e tjera të ngjashme, në të cilat u janë vrarë të afërmit, apo nga pikëllimi për shkak të okupimit të qytetit të lindjes — Dibrës.

Personazhet e tregimeve të Stërmillit janë njerëz të rinj që duan shumë, por kanë pak mundësi për tejkalimin e pengesave dhe për realizimin e qëllimeve e të dëshirave të veta. Stërmilli nuk kujdeset që personazheve t'u krijojë rrethana që do t'u mundësonin realizimin e qëllimeve, të dëshirave, të detyrave e të përpjekjeve të tyre. Atij sikur më shumë i pëlqen t'i shohë personazhet e veta si vuajnë, si për shkak të pikëllimit, sëmuren nga tuberkulozi e vdesin me mallin e atdheut të lirë e të dashurisë pa fat, si vuajnë nëpër burgje pse mbrojnë moralin e dinjitetin që, mandej, t'i çmojë, t'i respektojë e t'i dojë ai vetë dhe lexuesi. Personazhet e Stërmillit, sidomos ato që janë pozitive, janë të kapluar nga melankolia, nga sentimentalizmi dhe përjetojnë kriza të ndryshme emocionale të shkaktuara nga mospërmbushja e qëllimeve dhe e dëshirave. Vuajtjet, pikëpamjet e problemet e tyre janë mjaft uniforme. Zgjidhja e problemeve të tyre është paraqitur në stilin zi-bardh (jo bardh-zi). Vetitë kryesore të karakterit të shumicës së personazheve të tregimeve të Stërmillit janë gati të njësuara. Ato stolisen me ndjenjën e theksuar patriotike, me pastërtinë morale, me besnikëri e sinqeritet, me vendosmëri për të flituar edhe jetën për ideal, për moral e për dashuri të pastër. Te disa personazhe, duke bërë përpjekje për analizë psikologjike të tyre, Stërmilli heton dilemën si preokupim të përkohshëm (Eqrem Vetima i tregimit „Dora e djathtë”, Rifati i tregimit „Zemra që lëngojnë”, Ismeti i tregimit „As për mue, as për ju” etj.). Këto personazhe bien në konflikt me vetveten meqenëse gjenden para dy problemeve ose para një problemi që ka dy zgjidhje. Konflikti shkaktohet kur prej personazhit del (lind) *uni* tjetër — uni i dytë. Lufta midis këtyre dy *unëve* të të njëjtit personazh përfundon, rëndom, në favor të *unit* që gjendet në ato pozita në të cilat gjendet shumica e mjedisit shoqëror dhe vetë autori.

Tregimet e Stërmillit i karakterizon edhe mikrostruktura uniforme. Ato kanë stil të njëjtë, fjalor të njëjtë; personazhet flasin njësoj — në gjuhën e autorit. Në gjuhën e tyre dominojnë ofshamet, pasthirmat, mallkimet etj. Lutja dhe këshilla janë mjete të shpeshta poetike në tregimet e Stërmillit, janë forma të shprehjes sentimentale me të cilat synohet korrigjimi i sjelljeve, i veprimeve dhe i botëkuptimeve të ndryshme. Mikrostrukturës së prozës tregimtare të Stërmillit i mungon figuracioni, simbolika e alegoria, kurse patosi i theksuar dhe emfaza janë veçori të saj.

Si përfundim, në mbështetje të të gjitha këtyre që u thanë deri tashti, tregimet e Stërmillit janë dëshmi letrare të shumë raporteve shoqërore të një kohe të caktuar, të një gjendjeje politike me shumë travaja, të traumave të rënda e të idealeve të larta, të veseve e të zakoneve prapanike, por edhe të pastërtisë morale të shoqërisë shqiptare midis dy luftërave botërore. Mirëpo, skematizmi, shablonizmi, deklarativizmi, uniformizmi, stampa rutina, zgjidhjet e rastësishme e të pamotivuara sa duhet, gjuha uniformë

pa simbolikë e figuracion, ngjashmëria ontologjike etj., i bëjnë tregimet e Stërmillit si të paarrira. Megjithëkëtë, proza tregimtare e Stërmillit, me gjithë të metat strukturore, është e rëndësishme, meqë na shpie në kontekstin e kohës, në problemet e rënda jashtëletrare të shoqërisë shqiptare, të cilat shkrimtari i vlerëson dhe i gjykon. Atë e përshkon një lirizëm i hollë, një ndjeshmëri e një humanizëm i theksuar, një ndjenjë e fortë patriotike, prandaj një kohë të gjatë qe literaturë e dashur (gati) e të gjitha kategorive shoqërore e sidomos e rinisë shqiptare në periudhën midis dy luftërave botërore.

Kajtaž Rrecaj

LA PROSE NARRATIVE DE HAKI STERMILLI

R é s u m m é

Stërmilli débuta dans la création littéraire avec des récits qu'il publia en deux périodes temporelles. Il publia le premier groupe de ses récits au début des années 1920, tandis que le deuxième au début des années 1940. Il laissa un manuscrit de deux recueils de cinquante récits („Zemra të shitueme” („Coeurs blessés”) et „Hijet e kuqe” („Les Ombres rouges”) dont il en publia plus de quarente.

La question de la patrie, l'amour et la préservation de la pureté morale sont les thèmes de ces récits. Stërmilli écrit souvent sur les mêmes segments de la vie sociale comme insatisfait de ce qu'il avait écrit auparavant. Il revient souvent sur les mêmes thèmes, incité à élever la voix sur les problèmes sociaux et politiques, sur les problèmes des jeunes filles et de la femme albanaise en général, afin d'influer sur les lecteurs et la société de l'époque pour que ceux-ci prennent conscience de la situation insupportable de la jeunesse albanaise, en particulier de la jeune fille, et contribuent à l'amélioration de la vie de cette jeunesse, à l'émancipation de la femme à son enseignement et à son traitement juste. Ses récits traitent des thèmes humains qui constituaient des lourdes plaies dont souffrait le peuple albanais et sa jeunesse en particulier.

Stërmilli accorde une grande importance au domaine de la vie d'où il tire ses thèmes. Il pénètre dans les segments les plus sensibles de la vie sociale d'où il tire les thèmes de la patrie, celui de l'amour et de la morale. Ces thèmes déterminent la thipologie des récits de Stërmilli. Il traite habituellement ces thèmes un par un, mais souvent il en traite deux dans un même récit. Ainsi ces récits constituent quatre genres de récits: le type des récits à deux motifs, celui des récits sur la morale, ceux qui traitent de l'amour et ceux qui traitent de la patrie.

La structure poétique des récits de Stërmilli est caractérisée par le sentimentalisme contenant des éléments du romantisme et du réalisme.

Les personnages de Stërmilli sont des jeunes très amoureux qui, du fait qu'ils possèdent très peu de moyens de surpasser les obstacles pour la réalisation de leurs buts et désirs, sont imprégnés de mélancolie, de sentimentalisme et subissent des crises émotionnelles. Les principales qualités sont communes à presque tous les personnages de Stërmilli. Ils sont munis de forts sentiments patriotiques, de pureté morale, de fidélité, de sincérité et sont décidés à sacrifier leur vie pour leur idéal, leur morale et leur amour pour la patrie.

Ces récits sont les témoins de nombreux rapports sociaux de l'époque déterminée, d'une situation politique chargée de soucis, de traumatismes profonds et de sublimes idéaux, de vices et de coutumes arriérées ainsi que de la pureté morale de la société albanaise entre les deux guerres mondiales. Cependant, le schématisme, l'uniformisme, la ressemblance ontologique, la routine, les heureuses coïncidences, la langue uniforme, etc., font que les récits de Stërmilli ne semblent pas encore mûres. Toutefois, malgré ses défauts de structure, la prose narrative de Stërmilli est importante puisqu'elle nous plonge dans un contexte temporel, dans graves problèmes extra-littéraires de la société albanaise que l'écrivain évalue et juge. Cette prose est traversée par un lyrisme subtil, une sensibilité et un humanisme prononcés, une puissante note patriotique et, de ce fait, elle fut pendant longtemps la lecture préférée de presque toutes les catégories sociales, particulier de la jeunesse albanaise d'entre les deux guerres mondiales.

